



safejournalists.net

KOSOVË **Treguesit e nivelit të lirisë së** **mediave dhe Indeksi i Sigurisë** **së Gazetarëve 2023**

Autorë
Getoarbë Mulliqi & Leonita Morina



TABELA E PËRMBAJTJES

Rreth Projektit	2	C. Siguria e gazetarëve	23
Shpjegim i treguesve	2	C.1 Gazetarët dhe aktorët e mediave kanë qasje në	
Shpjegim metodologjik	3	masat mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive	
Treguesit kualitativë për nivelin e lirisë	4	kur kërcënohen	23
së mediave dhe sigurisë së gazetarëve	5	C.2 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias (jeta	
Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve	6	ose integriteti fizik i të cilëve janë në rrezik real dhe	
Lista e shkurtesave	6	të menjëhershëm) kanë qasje në mekanizma të	
		veçantë mbrojtjeje/sigurie	23
I Hyrje	7	C.3 Gazetarët femra kanë qasje në masat ligjore	
		dhe mekanizmat mbështetës kur përballen	
II Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në	9	me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë	
Kosovë – Treguesit	9	gjinore	24
A. Masat mbrojtëse ligjore dhe zbatimi i tyre	9	C.4 Është vendosur praktika e dënimit të	
A.1 Garancitë themelore për lirinë e mediave dhe	9	rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj	
gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë	9	gazetarëve dhe mediave	25
A.2 Pavarësia dhe efikasiteti i autoritetit	10	C.5 Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj	
rregullator	10	çështjeve të mbrojtjes së gazetarëve	25
A.3 Pavarësia dhe autonomia e shërbimit publik të	11	C.6 Njësitë e specializuara të hetimit dhe/	
mediave	11	ose oficerët janë të pajisur me ekspertizën	
A.4 Mbështetja financiare për gazetarinë cilësore	12	përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj	
dhe përmbajtjen mediatike me interes publik	12	gazetarëve	26
A.5 Reklamimi shtetëror në sektorin e mediave	13	C.7 Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj	
private	13	gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave	
A.6 Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen	13	kryhen me efikasitet (në mënyrë të pavarur,	
dhe zbatimi i tyre nuk krijojnë efekt ftohës për	13	tërësisht dhe menjëherë).	27
gazetarët dhe mediat	13	C.8 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave	
A.7 Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive	14	mbrohen në mënyrë efikase nga forma të	
dhe u mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve	14	ndryshme të ngacmimeve në internet.	28
të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të	14	C.9 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe	
sigurt	14	dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të	
A.8 Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve	15	mediave kryhen në mënyrë transparente	29
është i garantuar në legjislacion dhe respektohet	15	C.10 Sistemet e grumbullimit të statistikave	
nga autoritetet	15	cilësore të krijuara nga autoritetet shtetërore për	
A.9 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin	15	të frenuar mosndëshkimin	29
e tyre dhe të krijojnë, anëtarësohen dhe marrin	15	C.11 Kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike	30
pjesë në shoqatat e tyre	15	C.12 Kërcënime ndaj jetës dhe sigurisë fizike të	
A.10 E drejta për qasje në dokumente dhe	16	gazetarëve	33
informacione zyrtare	16	C.13 Sulmet aktuale	34
B. Masat mbrojtëse ligjore dhe zbatimi i tyre	18	C.14 Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe	
B.1 Pozicioni i punës i gazetarëve është i	18	shoqatave të gazetarëve	36
qëndrueshëm dhe i mbrojtur në vendin e punës	18	III Përfundime dhe rekomandime	38
B.2 Pavarësia editoriale në mediat private	19	IV Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Kosovë –	42
B.3 Pavarësia editoriale në mediat e shërbimit	19	2023	
publik	19		
B.4 Pavarësia editoriale në sektorin e mediave	20		
jofitimprurëse	20		
B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të	21		
lajmeve	21		
B.6 Pozita e punës së grave gazetare	21		

Rreth Projektit

SHPJEGIM I TREGUESVE

Shoqatat e gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të mbështetura nga Komisioni Evropian¹, kanë krijuar platformën [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) për të monitoruar së bashku legjislacionin dhe praktikën e mediave në vendet e tyre dhe të angazhohen në avancimin e mjedisit ligjor dhe institucional në të cilin punojnë gazetarët dhe profesionistët e tjerë të mediave. Çdo vit, bazuar në një metodologji të hartuar me kujdes², partnerët e [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) kryejnë kërkime avokuese që u kanë ofruar shoqatave të gazetarëve të dhëna të bazuara në prova, të besueshme dhe relevante për problemet dhe pengesat kryesore në zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e lirisë dhe sigurisë së mediave dhe gazetarëve në Ballkanin Perëndimor. Rezultatet e hulumtimit të avokimit u japin përmbajtje aktiviteteve të partnerëve, duke u ofruar atyre prova dhe shembuj të rinj që përmirësojnë dhe forcojnë pozicionet e tyre të avokimit.

Mjeti i parë cilësor i kërkimit – *Treguesit mbi nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve*, u zhvillua për herë të parë në vitin 2016 dhe u akordua gradualisht gjatë viteve. Ai përbëhet nga tre grupe treguesish: (A) Mbrojtja ligjore, (B) Pozicioni i gazetarëve në redaksi dhe (C) siguria e gazetarëve. Bazuar në këtë mjet monitorimi, janë publikuar gjithsej shtatë vlerësime, i fundit për vitin 2022.

Mjeti i kërkimit kuantitativ – *Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve*, u zhvillua në vitin 2020 dhe u testua në vitin 2021. Ai është krijuar për të 'matur' ndryshimet në mjedis që kanë ndikim të drejtpërdrejtë

- 1 Në dhjetor 2022, Komisioni Evropian miratoi një cikël të ri trevjeçar të Projektit [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net), i cili është vazhdim i dy fazave të mëparshme: projekti Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për mbrojtjen e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve (01.2016- 12.2018) dhe Safejournalist.net (02.2020-03.2023). Objektivi kryesor i Projektit është fuqizimi dhe forcimi i rolit të shoqatave kombëtare të gazetarëve, anëtarë të Platformës [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net), të bëhen akterë të pavarur efektivë dhe të përgjegjshëm në avokimin dhe krijimin e politikave përkatëse të mediave në vendet e tyre: Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë (IJAS), Shoqata e Gazetarëve të BH (BHJ), Shoqata e Gazetarëve Kroatë (CJA), Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AJK), Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (AJM) dhe Sindikata e Mediave të Malit të Zi (TUMM). Projekti financohet nga Programi i BE-së për Shoqërinë Civile dhe Media në favor të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë për 2021-2023 (IPA III).
- 2 Hulumtimi për avokim është dizajnuar dhe koordinuar nga Snežana Trpevska dhe Igor Micevski, bashkëpunëtorë hulumtues të Institutit Kërkimor për Zhvillim Social RESIS, nga Maqedonia e Veriut (www.resis.mk).

ose të tërthortë në atë se sa të sigurt ndihen gazetarët dhe akterët e tjerë të mediave kur ushtrojnë profesionin e tyre. Ai përbëhet nga katër grupe treguesish: (1) Mjedisi ligjor dhe organizativ, (2) parandalimi i duhur, (3) Procesi i duhur dhe (4) Siguria aktuale. Bazuar në këtë mjet, u zbatuan gjithsej tri cikle kërkimore: 2020 (viti pilot), 2021 dhe 2022.

Duke filluar nga viti 2023, [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) do të kombinojë dy mjetet e kërkimit (kualitativ dhe kuantitativ) në një projekt të vetëm kërkimor të avokimit – *Treguesit mbi nivelin e lirisë së mediave dhe Indeksit të Sigurisë së Gazetarëve*. Platforma monitoron situatën në shtatë vende: Shqipëria, Bosna & Hercegovina, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova³ dhe Serbia.

SHPJEGIM METODOLOGJIK

I gjithë procesi i kërkimit është ndarë në dy faza: në *fazën e parë*, janë mbledhur të dhëna për të gjithë treguesit kualitativë – si për liritë e mediave ashtu edhe për sigurinë e gazetarëve, ndërsa në *fazën e dytë*, treguesit kualitativë për sigurinë e gazetarëve janë shndërruar në kuantitativë dhe është kryer procedura e pikëzimit dhe përlllogaritjes së Indeksit të Sigurisë së Gazetarëve.

Një sërë metodash të ndryshme kërkimi u aplikuan për të mbledhur dhe analizuar të dhëna në lidhje me secilin tregues kualitativ specifik:

- Rishikimi i studimeve, analizave, raporteve kërkimore, dokumenteve të politikave, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analiza kualitative e dokumenteve ligjore;
- Marrja dhe analiza e informacionit të publikuar në faqet e internetit të institucioneve publike dhe organizatave dhe organeve të tjera;
- Marrja dhe analiza e njoftimeve për shtyp, njoftimeve dhe informacioneve të tjera të prodhuara nga organizatat profesionale;
- Të dhënat dytësore të mbledhura nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervista të thelluara me ekspertë, gazetarë, politikëbërës etj.;
- Fokus grupet me gazetarë, dhe
- Anketa me gazetarë (në disa prej vendeve).

³ Ky emër është pa paragjykim për statusin dhe në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe mendimin e Tribunalit për Shpalljen dhe Pavarësinë e Kosovës.

Në nivel kombëtar, hulumtimi i avokimit është kryer nga studiues kombëtarë të cilët kryejnë mbledhjen e të dhënave dhe hartojnë raportet narrative, të cilat më pas u shqyrtuan nga mediat lokale dhe ekspertët ligjorë dhe nga hulumtuesi kryesor. Në Kosovë, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka nominuar Getoarbe Mulliqin si studiuese kombëtare dhe Leonita Morina, si asistente hulumtuese. Dy ekspertë kombëtarë u emëruan gjithashtu për të rishikuar raportin: Abit Hoxha si ekspert i mediave dhe Yll Zekaj si ekspert juridik.

TREGUESIT KUALITATIVË PËR NIVELIN E LIRISË SË MEDIAVE DHE SIGURISË SË GAZETARËVE

Tabela e mëposhtme paraqet të gjithë treguesit kualitativë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve, të ndarë në tri fusha. Këta tregues kualitativë paraqiten në formë përshkruese ose narrative. Pjesët e treguesve që përdoren në kornizën konceptuale për Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve janë shënuar në tabelë me ngjyrë hiri.

Pasqyrë e të gjithë treguesve kualitativë (Treguesit kualitativë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve)

A. Masat mbrojtëse ligjore dhe zbatimi i tyre	B. Pozicioni i gazetarëve në redaksi	C. Siguria e gazetarëve
A.1 Garancitë themelore për lirinë e mediave dhe gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë	B.1 Pozicioni i punës i gazetarëve është i qëndrueshëm dhe i mbrojtur në vendin e punës	C.1 Gazetarët dhe akterët e mediave kanë qasje në masat mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive
A.2 Pavarësia dhe efikasiteti i autoritetit rregullator	B.2 Pavarësia editoriale në mediat private	C.2 Gazetarët dhe akterët e tjerë të mediave kanë qasje në mekanizma të posaçëm mbrojtjeje ose sigurie
A.3 Pavarësia dhe autonomia e shërbimit publik të mediave	B.3 Pavarësia editoriale në mediat e shërbimit publik	C.3 Gazetarët femra kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetës
A.4 Mbështetja financiare për gazetarinë cilësore dhe përmbajtjen mediatike me interes publik	B.4 Pavarësia editoriale në sektorin e mediave jofitimprurëse	C.4 Praktika e dënimit të rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave
A.5 Reklamimi shtetëror në sektorin e mediave private	B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	C.5 Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj çështjeve të mbrojtjes së gazetarëve
A.6 Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk krijojnë efekt ftohës për gazetarët dhe mediat	B.6 Pozita ekonomike e grave gazetare	C.6 Njësitë/zyrtarët e specializuar janë të pajisur me ekspertizë për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve
A.7 Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe u mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt		C.7 Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen me efikasitet
A.8 Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është i garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet		C.8 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efikase nga forma të ndryshme të ngacmimeve në internet.
A.9 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të krijojnë, anëtarësohen dhe marrin pjesë në shoqatat e tyre		C.9 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente
A.10 E drejta për qasje në dokumente dhe informacione zyrtare		C.10 Sistemet e grumbullimit të statistikave cilësore të krijuara nga autoritetet shtetërore për të frenuar mosndëshkimin
		C.11 Kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike

INDEKSI I SIGURISË SË GAZETARËVE

Duke marrë parasysh standardet dhe rekomandimet e vendosura nga Këshilli i Evropës dhe organizata të tjera ndërkombëtare, koncepti i "sigurisë së gazetarëve"⁴ u funksionalizua duke marrë parasysh katër dimensionet e mëposhtme:

- I. **Mjedisi ligjor dhe organizativ** – ekzistenca dhe zbatimi i masave mbrojtëse ligjore të rëndësishme për sigurinë e gazetarëve.
- II. **Parandalimi i duhur** – ekzistenca dhe zbatimi i një sërë masash parandaluese që kanë efekte të drejtpërdrejta në mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve.
- III. **Procesi i rregullt** – sjellja e institucioneve shtetërore dhe zyrtarëve publikë ndaj gazetarëve dhe efikasiteti i sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me hetimin e kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve.
- IV. **Siguria aktuale** – incidente dhe raste të formave të ndryshme të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve dhe mediave.

Tabela e mëposhtme paraqet katër dimensionet dhe treguesit që përbëjnë modelin teorik të konceptit "siguria e gazetarëve". Të dhënat për të gjithë këta tregues u mbledhën në fazën e parë të hulumtimit, dhe në fazën e dytë, bazuar në dëshmitë e mbledhura kërkimore, nëntë anëtarë të Panelit Këshillimor nga secili prej vendeve⁵ vlerësuan situatën dhe caktuan pikë për secili nga 19 treguesit:

Përmbledhje e treguesve në lidhje me Indeks të Sigurisë së Gazetarëve

I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	II. Parandalimi i duhur	III. Procesi i rregullt	IV. Siguria aktuale
1.1 Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk krijojnë efekt ftohës për gazetarët dhe mediat	2.1 Gazetarët dhe akterët e mediave kanë qasje në masat mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive	3.1 Njësitë/zyrtarët e specializuar janë të pajisur me ekspertizë për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve	4.1 Kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike
1.2 Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është i garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet	2.2 Gazetarët dhe akterët e tjerë të mediave kanë qasje në mekanizma të posaçëm mbrojtjeje ose sigurie	3.2 Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen me efikasitet	4.2 Kërcënime ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

4 Studiuësit nga Instituti RESIS (www.resis.mk), Snežana Trpevska, Igor Micevski dhe Ljubinka Popovska Toševa zhvilluan [kornizën konceptuale dhe metodologjike](#) për Indeks të Sigurisë së Gazetarëve dhe modelin për grumbullimin, peshimin dhe llogaritjen e tij.

5 Anëtarët e Panelit Këshillimor në Kosovë ishin: Albana Rexha Raca, Aleksandra Jovanovic, Besian Beha, Imer Mushkolaj, Labinot Leposhtica, Latif Mustafa, Leonora Dalipi, Mexhide Demolli Nimani, Serbeze Haxhijaj Isufi.

I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	II. Parandalimi i duhur	III. Procesi i rregullt	IV. Siguria aktuale
1.3 Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe u mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt	2.3 Gazetarët femra kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetës	3.3 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efikase nga forma të ndryshme të ngacmimeve në internet.	4.3 Sulmet aktuale
1.4 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të krijojnë, anëtarësohen dhe marrin pjesë në shoqatat e tyre	2.4 Praktika e dënimit të rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave	3.4 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente	4.4 Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve
1.5 Pozicioni i punës i gazetarëve është i qëndrueshëm dhe i mbrojtur në vendin e punës	2.5 Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj çështjeve të mbrojtjes së gazetarëve	3.5 Sistemet e grumbullimit të statistikave cilësore të krijuara nga autoritetet shtetërore për të frenuar mosndëshkimin	

Shënim: Kur në këtë raport përdoret gjinia mashkullore, ajo gjithmonë i referohet njëkohësisht femrave, meshkujve dhe individëve të ndryshëm. Emërtimet e shumta nuk janë përfshirë për hir të lexueshmërisë më të mirë.

— LISTA E SHKURTESAVE

KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
AGK	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KMSHK	Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
TSHP	Transmetimi i Shërbimit Publik
PK	Policia e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Hyrje

Kosova është republikë demokratike parlamentare; Presidenti i Kosovës është kreu i shtetit dhe Kryeministri i Kosovës është kreu i qeverisë. Kuvendi i Kosovës ka 120 ulëse, prej të cilave 20 janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve joshumicë në Kosovë, 10 për komunitetin serb dhe 10 për komunitetet tjera si boshnjake, turke, ashkali, rome, egjiptiane dhe gorane. Demografikisht Kosova është mjaft e larmishme në përbërjen e saj. Shqiptarët e Kosovës përbëjnë shumicën e popullsisë, dhe pjesën tjetër të popullsisë e përbëjnë komunitetet tjera joshumicë si serbët, boshnjakët, turqit, romët, ashkalitë dhe goranët. Gjuha shqipe dhe serbe janë gjuhët zyrtare në vend. Megjithatë, gjuhët turke, boshnjake dhe rome kanë status zyrtar në disa komuna. Sa i përket kulturës së tij politike, korrupsioni mbetet shqetësim i madh, kështu që përpjekjet për forcimin e institucioneve demokratike dhe luftimin e korrupsionit vazhdojnë të jenë vendimtare për zhvillimin politik të vendit.

Peizazhi mediatik i Kosovës konsiderohet mjaft i larmishëm dhe dinamik. Peizazhi mediatik në Kosovë përbëhet nga dy nivele, media kombëtare dhe media rajonale/lokale. Sa i përket sektorit televiziv, transmetuesi publik RTK luan rol vendimtar, edhe pse ky sektor kryesisht dominohet nga kanalet private. Në Kosovë ekzistojnë nëntëmbëdhjetë (19) kanale televizive të licencuara, pesë (5) prej të cilave ofrojnë shërbime të transmetimit televiziv në gjuhën serbe. Gjithashtu, ekzistojnë tetëdhjetë e nëntë (89) radio stacione, njëzet e dy (22) transmetojnë në serbisht, tre (3) në boshnjakisht, dy (2) në goranisht dhe një (1) në turqisht. Gjatë viteve të fundit janë krijuar kanale të reja televizive si ATV dhe TëVë1. Gjithashtu, janë krijuar edhe media të reja online, si Nacionale dhe Paparaci. Sa i përket rregullimit të mediave në Kosovë, mediat në Kosovë rregullohen nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) dhe Komisioni i Pavarur për Media. KPM-ja është organ i pavarur përgjegjës për menaxhimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. Në anën tjetër, KMSHK është organ vetërregullues i themeluar nga sektori i mediave të shkruara në Kosovë. Është e rëndësishme të theksohet se anëtarët e bordit të

KPM-së dhe RTK-së zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës dhe janë përgjegjës për menaxhimin e këtyre institucioneve.

Sa i përket krizës ekonomike, Kosova ka pasur një krizë të vazhdueshme ekonomike. Megjithatë, një pengesë mjaft e rëndë u përjetua në vitin 2020 me shpërthimin e pandemisë COVID-19, e cila pati ndikim të madh në funksionimin e të gjithë sektorit të mediave. Gazetat ishin një nga burimet kryesore të informacionit në Kosovë, por kjo ka ndryshuar për shkak të shpërthimit të COVID-19, duke e lënë Kosovën pa media të shkruara. Përveç kësaj, numri i mediave online është rritur shumë gjatë këtyre kohërave.

Për më tepër, gazetarët në Kosovë vazhdojnë të jenë cak i sulmeve politike dhe situata e sigurisë së gazetarëve në vend mbetet shqetësuese, me numrin më të madh të sulmeve të regjistruara këtë vit. Një nga rastet më shqetësuese lidhur me sulmet politike ishte heqja e licencës për biznes të Klan Kosovës. Një ngacmim i tillë administrativ nga qeveria ka kërcënuar pluralitetin mediatik në Kosovë. Për më tepër, për shkak të sulmeve verbale të vazhdueshme të pushtetit ndaj mediave, gazetarët janë shumë shpesh cak i ofendimeve nga publiku i gjerë, duke u akuzuar për bashkëpunim me armikun.

Liria e fjalës, mbrojtja e burimeve dhe qasja në informacion janë vetëm disa nga të drejtat ligjore të garantuara me kornizën ligjore të Kosovës. Megjithatë, një numër në rritje i gazetarëve janë përballur me SLAPP të paraqitura nga grupe të ndryshme biznesi dhe politikanë.



Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Kosovë – Treguesit

A. MASAT MBROJTËSE LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

— A.1 GARANCITË THEMELORE PËR LIRINË E MEDIAVE DHE GAZETARËVE DHE ZBATIMI I TYRE NË PRAKTIKË

Kosova në Kushtetutën e saj në nenin 22, ka pranuar si pjesë të rendit të saj juridik disa instrumente dhe marrëveshje ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut. Këto marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare, gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në Kosovë dhe kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike⁶. Një nga aktet kryesore ndërkombëtare është Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Neni 10 i kësaj konvente garanton të drejtën e lirisë së shprehjes⁷. Interpretimi i Nenit 10 nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e shtrin lirinë e shprehjes për të përfshirë lirinë e publikimit dhe lirinë e hetimit, të cilat janë shumë të rëndësishme për gazetarinë hulumtuese. Pra, Kushtetuta e Republikës së Kosovës jo vetëm që garanton lirinë e shprehjes por edhe lirinë e informimit, lirinë e shtypit dhe të drejta të ngjashme. Edhe pse nuk është shprehur në mënyrë eksplicite, këto masa mbrojtëse ligjore përfshijnë të drejtën për qasje në internet.

Për më tepër, përveç të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ekzistojnë ligje dhe akte shtesë për zbatimin e të drejtave kushtetuese. Këtu përfshihen Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve dhe Kodi Penal (ndalimi i nxitjes së urrejtjes). Megjithatë, perceptohet gjerësisht se pavarësisht formulimit të plotë të këtyre akteve në legjislacion, ka ende raste kur ato mungojnë ose nuk zbatohen siç duhet. Nuk është regjistruar asnjë shkelje domethënëse e këtyre ligjeve

6 Kuvendi i Republikës së Kosovës. [Kushtetuta e Republikës së Kosovës me Amendamentet I-XXV](#), 2017.
7 Këshilli i Evropës. [Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut](#), 1950.

dhe garancive, si për shembull shteti që përpiket të kufizojë internetin përmes bllokimeve të përmbytjes ose filtrave.

Gjatë vitit 2023, nuk ka pasur nisma të reja që synojnë ndryshimin e legjislacionit për media. Pra, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndryshime apo përditësime të kornizave ekzistuese ligjore që rregullojnë veprimtarinë e mediave në Kosovë. Megjithatë, gjatë vitit 2021, Kuvendi i Kosovës ndërmoi disa iniciativa me dyer të mbyllura që propozuan ndryshime në Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM).

Gjatë vitit 2023, nuk ka pasur asnjë përpjekje nga autoritetet shtetërore për të vendosur licencim apo kërkesa të tjera strikte për krijimin e mediave të shkruara dhe të bazuara në internet. Përveç kësaj, sipas bazës së të dhënave të AGK-së, nuk ka të dhëna të autoriteteve shtetërore që zbatojnë licencimin apo kërkesa strikte për themelimin e mediave të shkruara dhe të bazuara në internet në vitet e kaluara.

— A.2 PAVARËSIA DHE EFIKASITETI I AUTORITETIT RREGULLATOR

Procedurat e emërimit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) nuk janë përmbyshur, gjë që tregon mungesë transparence dhe llogaridhënieje. Ky qëndrim mbështetet nga disa burime, përfshirë Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD) në një deklaratë publike më 16 korrik 2021⁸. Në deklaratë theksohet se Kuvendi i Kosovës nuk i ka përmbyshur obligimet kushtetuese në mënyrë të hapur dhe transparente gjatë procesit të emërimit. Asnjë nga datat për intervistimin e kandidatëve nuk iu komunikua anëtarëve të shoqërisë civile, të cilët për këtë arsye e konsideruan procesin jotransparent⁹. Për më tepër, gjatë majit 2023 ka pasur mungesë integriteti në procesin e emërimit të anëtarëve të rinj të KPM-së. Kuvendi emëroi anëtarët e KPM-së, të cilët publikisht dihej se ishin të lidhur me partinë politike Lëvizja Vetëvendosje në pushtet në Kosovë. Kjo çështje shkaktoi reagime publike nga mediat e pavarura, OJQ-të në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare të cilat e panë këtë si proces të politizuar¹⁰¹¹.

Mediat e Pavarura në Kosovë kishin sfida të mëdha operacionale për shkak të dështimit të Kuvendit për të emëruar anëtarët e rinj në kohë. KPM nuk ka qenë funksionale për më shumë se shtatë muaj, nga 16 tetori 2022 deri më 24 maj 2023. Sipas Miftarajt nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, para datës 16 tetor 2022, KPM-ja përbëhej nga gjashtë anëtarë. Meqenëse mandati i kryetarit dhe i zëvendëskryetarit përfundoi më 16 tetor 2023, KPM-ja mbeti me vetëm katër anëtarë¹². Sipas Ligjit për KPM-në, kuorumi për mbajtjen e mbledhjeve është katër anëtarë, mirëpo për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarit kërkohen pesë anëtarë¹³. Prandaj, përderisa KPM-ja ka plotësuar kuorumin për mbajtjen e mbledhjeve, nuk ka mundur të plotësojë kuorumin

8 Instituti i Kosovës për Drejtësi, [IKD publikon gjetjet e monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për sesionin pranveror 2024](#), 2024.

9 Miftaraj, Ehat. "Intervistë me Ehat Miftaraj – Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD). 2 shkurt 2024.

10 Prishtina Insight, [Qeveria e Kosovës përballet me reagime të ashpra për projektligjin mbi licencimin e mediave](#), 2024.

11 KOHA Ditore, [Qeveria mbron ligjin për KPM-në, pavarësisht kritikave nga ndërkombëtarët](#), 2024.

12 Po aty.

13 Po aty.

për zgjedhjen e kryesisë së saj. Për shkak të mungesës së alternativave ligjore, KPM-ja mbeti jofunksionale deri më 24 maj 2023, kur përfundimisht znj. Luljeta Aliu u zgjodh anëtare e re e KPM-së nga Kuvendi. Më pas, më 6 qershor 2023, u mbajt mbledhja e parë e KPM-së, gjatë së cilës kryetar u zgjodh z. Jeton Mehmeti dhe nënkryetar z. Fatih Basha.

Pothuajse për gjysmën e parë të vitit 2023, KPM-ja ishte jofunksionale për shkak të dështimit të Kuvendit për të emëruar anëtarë të rinj brenda afateve. Ky mosveprim i Kuvendit pengon funksionimin e një institucioni të rëndësishëm kushtetues si KPM-ja, pasi nuk i adreson kërkesat për të cilat duhet të vendosë KPM-ja. Nga monitorimi i IKD-së, të gjeturat tregojnë se KPM-ja në përgjithësi i kryen aktivitetet dhe misionin e saj në mënyrë të pavarur dhe të drejtë. Më tej, Mushkolaj thotë se është e vështirë të thuhet se autoriteti rregullator funksionon plotësisht në mënyrë të pavarur, duke pasur parasysh formën e zgjedhjes së anëtarëve. Megjithatë, asnjë qasje diskriminuese ndaj procesit nuk është raportuar¹⁴. Licencimi i transmetimit dhe rregulloret tjera në Kosovë përgjithësisht administrohen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Gjithashtu, Imer Mushkolaj, Drejtor Ekzekutiv i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, konfirmon se, në pjesën më të madhe, licencimi i transmetimit dhe rregulloret tjera kryhen në mënyrë të drejtë dhe neutrale.

— A.3 PAVARËSIA DHE AUTONOMIA E SHËRBIMIT PUBLIK TË MEDIAVE

Në përputhje me mandatet ligjore, RTK-ja shërben si transmetues publik i Kosovës. RTK-ja është kritikuar shumë vitet e fundit për gjoja mbështetjen e objektivave politike dhe se shërben si mjet për propagandën e qeverisë, pavarësisht nga garancitë e ligjit nr. 04/L-046 për autonominë dhe pavarësinë e saj¹⁵. Në anën tjetër, avancimi i RTK-së është vlerësuar pozitivisht në Raportin e Progresit të BE-së për vitin 2022¹⁶. Si të tilla, ndryshimet e fundit në menaxhmentin e RTK-së janë pritur mirë.

Pavarësia e RTK-së në Kosovë është ende e paplotë, kryesisht për shkak të mbështetjes së madhe në financimin e shtetit. Në Raportin e Barometrit Vibrant të Informacionit të IREX në Kosovë 2023, thuhet se pavarësisht përpjekjeve, autonomia editoriale e RTK-së dhe stabiliteti financiar afatgjatë janë në rrezik për shkak të financimit të saj që përcaktohet çdo vit nga Kuvendi¹⁷. Kështu, një varësi e tillë nga financimi i drejtpërdrejtë shtetëror paraqet një sfidë të madhe për pavarësinë e RTK-së. Për më tepër, RTK-ja shpesh mbetet me financim të mangët dhe si shumicës së mediave në Kosovë, i mungon vetë-qëndrueshmëria financiare, duke u perceptuar shpesh si e pambrojtur ndaj ndikimeve politike dhe biznesore. Për më tepër, sipas një artikulli të Bamit (2022), buxheti i ndarë për vitin 2023 konsiderohet më i vogli i ndarë ndonjëherë për RTK-në në dekadën e fundit. Buxheti

14 Mushkolaj, Imer. "Intervistë me Imer Mushkolaj – Drejtor Ekzekutiv i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës". 2 shkurt 2024.

15 Republika e Kosovës. [Ligji Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare](#). Gazeta Zyrtare, 2012.

16 Komisioni Evropian. "[Raporti për Kosovën 2022](#)", 2022.

17 IREX. [Informacion i barometrit vibrant 2023](#).

prej 8.96 milionë euro për vitin 2023 mbetet i njëjtë me atë të vitit 2022 dhe është mjaft më i ulët se ndarja për 2021¹⁸.

Sipas Informacionit të Barometrit Vibrant IREX 2023, procesi i zgjedhjes së bordit të sapoformuar të transmetuesit publik, Radio Televizioni i Kosovës (RTK), është parë si transparent dhe i bazuar në merita nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare të përfshira në monitorim. Megjithatë, konsultimet me organizatat e shoqërisë civile nuk janë praktikë e zakonshme. Megjithatë, aktivistët e lirisë së mediave, në bashkëpunim me përfaqësues vendorë dhe ndërkombëtarë, monitorojnë rregullisht këto mbledhje të bordit. Mes tyre është edhe Flutura Kusari, e cila është veçanërisht e zëshme për çështje të tilla. Ajo e bën këtë përmes kanaleve të mediave sociale duke informuar në mënyrë aktive qytetarët si dhe të interesuarit për këto çështje¹⁹.

— A.4 MBËSHTETJA FINANCIARE PËR GAZETARINË CILËSORE DHE PËRMBAJTJEN MEDIATIKE ME INTERES PUBLIK

Që nga marsi 2020, me përhapjen e gjerë të COVID-19, media e shkruar ndaloi prodhimin e saj. Deri në mars të vitit 2020, Kosova kishte pesë gazeta ditore, Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot, Epoka e Re dhe Bota Sot. Ndërsa ky vendim supozohet se është marrë për të kontrolluar përhapjen e COVID-19, perceptohet gjerësisht se motivimi primar vjen nga sfidat financiare me të cilat ballafaqohen mediat e shkruara në Kosovë për një kohë shumë të gjatë. Si rezultat, në Kosovë nuk ka më gazeta të shtypura fizikisht, por vetëm botime online.

Për shkak të mungesës së financimit, organizatat e shoqërisë civile shumë shpesh theksojnë nevojën për një skemë financimi institucionale, veçanërisht për mediat e komunitetit lokal apo jo-shumicë. Për më tepër, bazuar në raportin e përgatitur nga IREX në vitin 2023, mediat private në Kosovë janë shumë të varura nga sponsorizimi dhe reklamimi për të financuar përmbajtjen që prodhojnë, duke i lënë ato të luftojnë më tej për të gjetur burime të tjera financimi²⁰.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, në bashkëpunim me Institutin Demokratik Kombëtar, organizoi një diskutim me mediat lokale në Kosovë, për të adresuar sfidat dhe vështirësitë me të cilat përballen²¹. Gjatë diskutimit u bisedua për nevojën e shpeshtë që media të tilla të funksionojnë pa dëmshpërblim dhe luftën për sigurimin e pagave të gazetarëve në kohë. Funksionimi i atyre që u shërbejnë komuniteteve gjuhësore joshumicë është veçanërisht i vështirë për shkak të mungesës së mekanizmave financues. Fatmir Menekshe, gazetar i Radio Romano Avazo, duke folur në emër të një medie që synon komunitetin rom në Kosovë, foli për vështirësinë në arritjen e stabilitetit financiar dhe gjenerimin e fitimit nga reklamat. Për më tepër, shumica e mediave në gjuhën serbe janë të regjistruara si organizata jofitimprurëse, duke u mbështetur

18 Bami, Xhorxhina. "Transmetuesi publik i Kosovës ankohet për buxhetin "më të vogël ndonjëherë", 18 nëntor 2022.

19 ECPMF, Kosova: ECPMF mirëpret përzgjedhjen e kandidatëve të rinj për Bordin e RTK-së, 2024.

20 IREX. Informacion i barometrit vibrant 2023.

21 Po aty.

në fondet operacionale nga donatorët ndërkombëtarë dhe vendorë. Sipas IREX, mediat e pavarura në gjuhën serbe financohen kryesisht nga projektet, me të ardhura minimale nga marketingu, duke çuar në mbylljen e disa mediave²².

— A.5 REKLAMIMI SHTETËROR NË SEKTORIN E MEDIAVE PRIVATE

Nuk ka praktikë të reklamimit shtetëror në Kosovë që nga ndërrimi i fundit i qeverisë. Qeveria aktuale ka braktisur plotësisht reklamimin në mediat private. Reklamimet shtetërore nuk ekzistojnë më. Në vend të kësaj, organet qeveritare promovojnë punën e tyre përmes mediave sociale ose faqeve të tyre të internetit. Megjithatë, ky ndryshim ka penguar ndjeshëm funksionimin e mediave lokale.

Thuhet nga Informacioni i Barometrit Vibrant 2023 se më shumë se dy të tretat e organeve të mediave po mbështeten në tregun lokal të reklamave dhe financat e donatorëve ndërkombëtarë²³. Kjo i vendos ata në një pozicion shumë sfidues në përpjekjen për të marrë fondet e nevojshme për të mbështetur përmbajtjen e tyre. E vetmja media që mund të garantojë fonde dhe financa të sigurta për operacionet është media publike e cila financohet nga buxheti i shtetit.

Shuma e shpenzuar nga institucionet qeveritare për reklamimin e vendeve të lira të punës, thirrjeve tenderuese apo fushatave të vetëdijesimit të publikut për çështje të ndryshme përgjatë vitit 2023 mbetet e pazbuluar. Gjithashtu, të dhënat në lidhje me buxhetet e alokuara të mediave nga institucionet qeveritare nuk janë të qasshme për publikun e gjerë.

— A.6 DISPOZITAT LIGJORE NË LIDHJE ME SHPIFJEN DHE ZBATIMI I TYRE NUK KRIJOJNË EFEKT FTOHËS PËR GAZETARËT DHE MEDIAT

Në Kosovë, Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, që ka hyrë në fuqi në vitin 2008, urdhëron që dispozitat e tij të interpretohen për t'i dhënë përparësi parimit të lirisë së shprehjes në përputhje me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, siç është elaboruar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut²⁴. Gjithashtu, bazuar në këtë legjislacion, në rastet e konfliktit të ligjit të brendshëm me Konventën Evropiane, kjo e fundit ka përparësi krahas precedentëve ligjorë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Sipas Miftarajt nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, IKD monitoron rreth 5 mijë seanca gjyqësore në vit në të gjitha gjykatat e Kosovës, duke përfshirë ato në çështjet civile që kanë të bëjnë me shpifjen²⁵. Vetëm në vitin 2023, IKD-ja ka vëzhguar rreth 60 seanca gjyqësore që përfshinin ankesa për shpifje të paraqitura kryesisht nga zyrtarët publikë kundër gazetarëve dhe aktivistëve

22 Po aty.

23 Po aty.

24 [LIGJI NR. 02/L-65 E DREJTA CIVILE KUNDËR SHPIFJES DHE FYERJES](#)

25 Miftaraj, Ehat. "Intervistë me Ehat Miftaraj – Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD). 2 shkurt 2024.

të shoqërisë civile²⁶. Në shumë raste, IKD-ja është përballur me aktakuza të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) që synonin gazetarët dhe aktivistët e shoqërisë civile²⁷. Nga monitorimi i IKD-së, shihet se gjykatat i trajtojnë të gjitha lëndët me profesionalizëm dhe drejtësi. Megjithatë, shqetësimet vazhdojnë në lidhje me efikasitetin e sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të tilla brenda një afati të arsyeshëm kohor. Gjithashtu, Mushkolaj argumenton se ndonjëherë dispozitat e ligjeve për shpifjen janë të ashpra ndaj gazetarëve dhe ka një tendencë për të mbrojtur zyrtarët publikë²⁸.

Numri i saktë i padive për shpifje kundër gazetarëve mbetet i panjohur. Përkundër komunikimit tonë si me Këshillin Prokurorial të Kosovës ashtu edhe me Gjykatën Supreme të Kosovës²⁹, nuk mundëm t'i merrnim këto të dhëna. Sipas gjetjeve të AGK-së, nuk ka pasur raste të padive për shpifje të iniciuara kundër gazetarëve nga zyrtarë shtetërorë dhe/ose politikanë gjatë vitit 2023, as nuk ka pasur vendime gjyqësore në të cilat paditësi ka qenë politikan apo individ tjetër me ndikim.

Gazetarët nuk i perceptojnë ligjet për shpifjen si dekurajuese; megjithatë, është shqetësuese për ta, ligje të tilla mund të sanksionojnë pa dashje informacion të pasaktë, qoftë me dashje apo jo³⁰. AGK-ja ka krijuar një bazë të brendshme të të dhënave që dokumenton paditë e ngritura kundër gazetarëve, e cila përbëhet nga mbi 35 raste të tilla. Në një intervistë të thelluar me Labinot Leposhticën nga Kallxo.com, jemi informuar se vetëm Kallxo ka më shumë se 13 padi³¹.

— A.7 LIGJET E TJERA ZBATOHEN NË MËNYRË OBJEKTIVE DHE U MUNDËSOJNË GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE TË PUNOJNË LIRSHËM DHE TË SIGURT

Paditë SLAPP nuk janë të njohura në legjislacionin e Kosovës dhe nuk ka mbrojtje për gazetarët dhe mediat nga veprime të tilla ligjore.

Që nga viti 2023, nuk është identifikuar apo raportuar asnjë rast i zbatimit diskriminues ose arbitrar të ligjeve të tjera që synojnë frikësimin dhe heshtjen e gazetarëve duke i ngarkuar ata me koston e një mbrojtjeje ligjore³².

Ka pasur raste kur gazetarët janë përballur me padi të shumta për shpifje. Megjithatë, për shkak të reagimit publik, gazetarët shpesh hezitojnë t'i bëjnë publike rastet e tyre. Për shembull, gazetari M.B. ka pranuar dy padi njëra pas tjetrës për shpifje, ndërsa është paralajmëruar edhe për padinë e tretë³³. Ai beson se këto padi kanë për qëllim t'u

26 Po aty.

27 Po aty.

28 Mushkolaj, Imer. "Intervistë me Imer Mushkolaj – Drejtor Ekzekutiv i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës". 2 shkurt 2024.

29 AGK-ja kërkon qasje në të dhëna dhe informacione, por në shumicën e rasteve, ky informacion është i paarritshëm nga institucionet. Gjatë pjesës së parë të vitit 2024, AGK-ja ka komunikuar disa herë me zëdhënës të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.

30 Fokus grup me gazetarë të transmetimeve, OJQ-ve dhe mediave online, realizuar nga Getoarë Mulliqi më 29.12.2023.

31 Leposhtica, Labinot. "Intervistë me Labinot Leposhticën – Koordinator i Monitorimit të Gjykatave dhe Zyrës Ligjore të BIRN Kosovës". Intervistuar nga Getoarë Mulliqi. 16 janar 2024.

32 Fokus grup me gazetarë të transmetimeve, OJQ-ve dhe mediave online, realizuar nga Getoarë Mulliqi më 29.12.2023.

33 M.B. Gazetar. Intervistuar nga Getoarë Mulliqi. 7 janar 2024.

mbyllin gojën gazetarëve dhe t'ua vështirësojnë kryerjen e detyrave profesionale. Edhe pse këto padi janë cilësuar si padi për shpifje, shumë shpesh ekspertët juridikë i referohen si padi Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP). Këto kostume synojnë të frikësojnë gazetarët duke vendosur barrë të konsiderueshme financiare.

— A.8 KONFIDENCIALITETI I BURIMEVE TË GAZETARËVE ËSHTË I GARANTUAR NË LEGJISLACION DHE RESPEKTOHET NGA AUTORITETET

Në Republikën e Kosovës, konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është i rregulluar me ligj. Në veçanti, në nenin 4 të Ligjit Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, gazetarëve dhe punonjësve tjerë të mediave u njihet e drejta për të mbajtur heshtje lidhur me burimet e tyre të informacionit³⁴. Si rezultat, ata nuk mund të detyrohen të zbulojnë burimet e tyre ose të ofrojnë materiale që mund të ekspozojnë identitetin ose origjinën e informacionit të tyre. Ata mund të detyrohen të zbulojnë identitetin e burimit vetëm kur urdhërohet nga një gjykatë kompetente dhe kur është thelbësore për të parandaluar një kërcënim serioz ndaj integritetit fizik, që mund të çojë në vdekje. Për më tepër, këto garanci mbështeten nga autoritetet në zbatim praktik (LIGJI NR. 04/L-137, 2013, neni 4).

Në vitin 2023, nuk kishte asnjë rast të regjistruar në bazën e të dhënave të AGK-së ku gazetarët ishin të detyruar të zbulonin burimet e tyre³⁵. Megjithatë, siç u përmend më lart, nëse ka raste kur ka rrezik për jetën e individëve ose kërcënim për shtetin, gjykata ka autoritetin për të kërkuar një informacion të tillë.

Gazetarët thonë se ndjehen të lirë të komunikojnë me burimet e informacionit, duke pasur parasysh se ligjet në Kosovë garantojnë konfidencialitetin e burimeve të gazetarëve³⁶. Shumica e gazetarëve pajtohen se korniza ligjore ofron mbrojtje solide, megjithatë në praktikë, është e vështirë të mbash heshtje për burimet e tyre të informacionit dhe të mbash konfidencialitet identitetin e informatorëve.

— A.9 GAZETARËT JANË TË LIRË TË USHTROJNË PROFESIONIN E TYRE DHE TË KRIJOJNË, ANËTARËSOHEN DHE MARRIN PJESË NË SHOQATAT E TYRE

Gazetarëve nuk u kërkohet të marrin licenca shtetërore për të përmbushur përgjegjësitë e tyre profesionale, pasi shteti nuk mandaton asnjë formë licencimi. Liria për të punuar është e pakufizuar për gazetarët dhe profesionistët e tjerë të mediave. Megjithatë, ata inkurajohen të mbajnë dokumente identifikimi të lëshuar nga organizata mediatike ku punojnë kur raportojnë për ngjarje specifike. Gjithashtu, nuk ka pasur përpjekje gjatë viteve të fundit për zbatimin e licencimit shtetëror.

34 [LIGJI NR. 04/L-137 PËR MBROJTJEN E BURIMEVE TË GAZETARISË](#)

35 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. "Baza e të dhënave të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës." 2023.

36 Fokus grup me gazetarë të transmetimeve, OJQ-ve dhe mediave online, realizuar nga Getoarbë Mulliqi më 29.12.2023.

Zakonisht gazetarët nuk e kanë problem të njihen si gazetarë në procedurat përkatëse para autoriteteve publike. Në vitin 2023, nuk ka pasur raste kur gazetarëve iu është mohuar të raportojnë për ngjarje specifike gjatë periudhës së raportimit³⁷.

Vitin e kaluar, nuk ka pasur presione apo pengesa të raportuara nga autoritetet, pronarët e mediave apo figura të tjera me ndikim që gazetarët t'i bashkohen shoqatave të tyre³⁸. Për më tepër, nuk ka asnjë tregues të organizatave mediatike paralele ose të rreme, aktivitetet e të cilave minojnë rolin vendimtar të shoqatave të mirëfillta gazetareske³⁹.

— A.10 E DREJTA PËR QASJE NË DOKUMENTE DHE INFORMACIONE ZYRTARE

Qasja në dokumentet zyrtare publike, si dhe e drejta për ripërdorimin e dokumenteve të tilla, u garantohet të gjithëve, pa diskriminim në asnjë bazë me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike⁴⁰. Megjithatë, sipas Raportit të të Drejtave të Njeriut për Kosovën nga Departamenti i Shtetit (2022), Institucioni i Avokatit të Popullit ka gjetur se institucioneve publike në Kosovë shpesh u mungon ekspertiza dhe personeli i nevojshëm për të adresuar kërkesat për qasje në dokumente publike⁴¹. Më pas, kjo çon në vonesa të konsiderueshme ose raste kur nuk jepet justifikimi ligjor për mohimin ose kufizimin e qasjes në informacion.

Nuk ka asnjë provë që sugjeron trajtim preferencial ndaj mediave të veçanta. Megjithatë, kur gazetarët nga fokus grupi u pyetën nëse qeveria dhe ministritë e saj mbajnë marrëdhënie të hapura dhe jodiskriminuese, ata u ankuan për mungesën e transparencës nga këto organe⁴². Shpesh, ata janë të detyruar t'i adresojnë këto shqetësime agjencisë së informacionit dhe privatësisë. Gazetarëve u sigurohet qasje e barabartë dhe e pakufizuar në seancat gjyqësore, duke përjashtuar rastet ku janë urdhëruar masa mbrojtëse nga gjyqtarët. Gjatë gjithë periudhës raportuese të vitit 2023, nuk ka pasur asnjë provë që gazetarëve iu është mohuar qasja në rastet e hapura gjyqësore.

Kuvendi i Republikës së Kosovës konsiderohet si institucioni më transparent në vend⁴³. Të gjitha seancat e Kuvendit, mbledhjet e komisioneve dhe mbledhjet e tjera caktohen dhe shpallen paraprakisht përmes kalendarit të aktiviteteve dhe uebfaqes zyrtare të Kuvendit⁴⁴. Për më tepër, procesverbalet e mbledhjeve dhe transkriptimet nga seancat plenare, së bashku me dokumentet e ndryshme të punës ditore, mund të gjenden në faqen e internetit të Kuvendit. Me më shumë se 400 gazetarë të akredituar që marrin pjesë në seancat, Kuvendi siguron qasje në media në përputhje me rregulloret e përcaktuara. Gazetarët, përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve dhe organizatave joqeveritare, lejohen të vëzhgojnë takimet, seancat publike

37 po aty.

38 Po aty.

39 Po aty.

40 Kuvendi i Republikës së Kosovës. [Ligji Nr.06/L-081 për Qasje në dokumente publike](#). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

41 Departamenti i Shtetit i SHBA-së. "[Raportet e vendit 2022 mbi praktikën e të drejtave të njeriut: Kosovë](#)" mars, 2022.

42 Po aty.

43 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Baza e të dhënave të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. Kosovë, 2023.

44 Kuvendi i Republikës së Kosovës. [Rregullore për Rendin dhe Qasjen e Mediave dhe të Publikut në Punën e Kuvendit të Kosovës](#), 2020.

dhe tryezat e rrumbullakëta të Kuvendit⁴⁵. Për më tepër, seancat plenare të Kuvendit transmetohen drejtpërdrejt nga Radio Televizioni Publik i Kosovës (RTK), me qasje në sinjalin e transmetimit të dhënë për të gjitha mediat e akredituara.

Për më tepër, Kuvendi zgjeron shtrirjen e saj duke transmetuar seanca të drejtpërdrejta në kanalin e saj në YouTube dhe faqen zyrtare të internetit, duke ofruar një platformë të qasshme për të gjitha mediat. Hapësira pas sallës së seancave plenare është në dispozicion të gazetarëve për të ndjekur punimet e Kuvendit. Në ballkonin e seancës plenare, media mund të vendosë vetëm një aparat fotografik gjatë seancës⁴⁶. Kështu, një çështje e ngritur nga gazetarët në diskutimet me AGK-në ishte për hapësirën e pamjaftueshme në dispozicion për të akomoduar të gjithë gazetarët në Kuvend. Konkretisht, gazetarët audio dhe video kërkojnë më shumë hapësirë dhe pajisje. Për më tepër, mungesa e listave të përditësuara të gazetarëve të akredituar nga kuvendi kontribuon në vështirësi të panevojshme dhe kushte jo të shëndetshme të punës për gazetarët.

45 Po aty.

46 Po aty.

B. MASAT MBROJTËSE LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

— B.1 POZICIONI I PUNËS I GAZETARËVE ËSHTË I QËNDRUESHËM DHE I MBROJTUR NË VENDIN E PUNËS

Nga të dhënat e mbledhura, u konstatua se afërsisht 25 për qind e gazetarëve punojnë me kontrata me afat të caktuar, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë të angazhuar me kontrata të përkohshme kryesisht për një vit⁴⁷. Më pak se 10 për qind e tyre kanë kontrata alternative, si kontrata afatshkurtra tre mujore ose kontrata për shërbime. Madhësia e mostrës për këta të intervistuar gazetarë përbëhet nga 212 individë, duke përfshirë anëtarë dhe jo anëtarë të AGK-së. Aktualisht, gazetarët e TSHP-së operojnë pa mbulim nga sigurimet shoqërore; megjithatë, është e rëndësishme të përmendet se kushtet për punëtorët e sektorit privat janë përmirësuar në krahasim me vitet e mëparshme.

Bazuar në komentet e 212 të anketuarve, përfshirë individë nga sektorët publikë, privatë, jofitimprurës dhe të pavarur, është konstatuar se pagat kanë pësuar një rritje prej 28 për qind. Në vitet e kaluara punëtorët e mediave kanë marrë kompensim deri në 350 euro. Megjithatë, një ndryshim i rëndësishëm ndodhi në vitin 2023: 12 për qind e të anketuarve kanë raportuar se kanë fituar deri në 350 euro, ndërsa shumica kanë deklaruar se pagat e tyre variojnë deri në 600 euro⁴⁸. Një pakicë thanë se paga e tyre i kalonte 800 euro e më shumë. Gjithsesi, gjendja e gazetarëve të pavarur është përkeqësuar për shkak të mungesës së kompensimit për pensionet dhe orët shtesë të punës, ata duhet ta mbulojnë atë duke punuar çfarëdo që nuk ka lidhje me gazetarinë.

Përkundër këtyre sfidave që gazetarët kanë kaluar deri më tani, pronarët e mediave kanë shtuar edhe një pengesë duke përcjellë orarin e tyre të punës brenda redaksisë. Gazetarëve u kërkohet të plotësojnë orarin e punës për ditën e përcaktuar në kontratën e tyre të punës dhe nëse këto orë pune nuk plotësohen ato pasqyrohen automatikisht në pagat e tyre. Megjithatë, kur ata tejkalojnë orarin e punës gjatë zhvillimit të storieve të tyre në terren, nuk ka kompensim siç kërkohet me ligj. Sa i përket nëse marrin pagesa të rregullta apo jo, sipas të anketuarve, shumica paguhen rregullisht⁴⁹. Megjithatë, gazetarët e mediave më të vogla, si ata në mediat lokale dhe portalet e sapokrijuara, hasin në vështirësi sa i përket pagave.

Ende nuk janë krijuar sindikata në sektorin privat të mediave; d.m.th. kjo situatë ka zgjatur disa vite dhe jo vetëm në vitin 2023. Për më tepër, ka mungesë të informacionit të disponueshëm nëse pronarët mbështesin apo pengojnë gazetarët në formimin e shoqatave apo sindikatave. Për më tepër, është e rëndësishme të përmendet se kontrata kolektive në Kosovë vlen vetëm për punëtorët e TSHP-së.

47 Getoarë Mulliqi Bojaj. "Anketa me 212 gazetarë kosovarë". 2023. Kjo anketë është kryer nga studimi Worlds of Journalism dhe pritet të publikohet në vitin 2025. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka marrë pjesë si partner në këtë anketë.

48 Po aty.

49 Po aty.

— B.2 PAVARËSIA EDITORIALE NË MEDIAT PRIVATE

Nuk ka asnjë provë që mbështet ekzistencën e dokumenteve organizative që ndajnë rreptësisht ndërmjet marketingut dhe redaksive⁵⁰. Edhe pse është praktikë e mediave që të ndajnë përmbajtjet e sponsorizuara nga artikujt informues. Pavarësisht se mediat private në Kosovë janë tërësisht të varura nga sponsorizimi, gazetarët njëzëri pohojnë se redaksia asnjëherë nuk ndikohet drejtpërdrejt⁵¹. Edhe pse gazetarët nuk janë të njohur me asnjë rregullore të brendshme për ndarjen e redaksisë dhe departamentit të marketingut, mediat private po bëjnë të pamundurën për të siguruar të ardhurat e tyre. Megjithatë, ata janë të vetëdijshëm për sponsorët më të mëdhenj dhe do të preferonin të abstenonin nga zhvillimi i një storie sesa t'u jepnin një ton pozitiv sponsorëve të tyre.

Shumica e mediave në të gjithë sektorët i përmbahen vetëm kodit të përgjithshëm të sjelljes⁵². Një zhvillim pozitiv ka ndodhur gjatë vitit 2023 pasi më shumë gazetarë pretendojnë se janë njohur me ato standarde etike nga eprorët e tyre. Nga ana tjetër, gazetarët me përvojë nuk pranojnë t'i shkelin ato rregulla etike dhe kode. Sipas "Vibrant Barometer Information 2023", të realizuar nga IREX, "Në Kosovë rrallëherë ka pasoja për mediat që bëjnë gabime për shkak të mungesës së edukimit mediatic, sundimit të brishtë të ligjit dhe dobësisë së rregullatorëve"⁵³.

Të pyetur për format më të zakonshme të presionit të ushtruar nga eprorët e tyre, gazetarët e mediave private argumentojnë se presioni i kohës është më i zakonshmi. Prandaj, sektori hulumtues në Kosovë është mjaft i kufizuar dhe shumë vështirë se zgjidhet. Krahasuar me vitet e kaluara, përveç gazetarëve të mediave online, edhe gazetarëve të televizionit u kërkohet të zhvillojnë më shumë se një lajm në ditë. Ndërsa në vitet e mëparshme, kuotat e rezultateve që duhet të plotësoheshin gjatë një dite pune ishin problem vetëm për gazetarët që punojnë ekskluzivisht për portalet private (???) online. Gjatë vitit 2023, gazetarëve që punojnë për televizione/ radio u kërkohet gjithashtu të përgatitin më shumë se një lajm të cilin duhet ta përshtatin edhe për portalin online të mediave të respektuara dhe/ose mediat e tyre sociale.

— B.3 PAVARËSIA EDITORIALE NË MEDIAT E SHËRBIMIT PUBLIK

Parimet etike dhe standardet profesionale të gazetarisë në kuadër të MSHP-ve janë të rregulluara me dokumente të brendshme. Njëzëri, gazetarët që ishin pjesë e anketës së AGK-së në vitin 2023 pohuan se respektohet kodi i etikës dhe se redaksia kujdeset që këto parime dhe standarde përmbushen⁵⁴. RTK-ja gjithashtu ka një komision disiplinor që është përgjegjës për trajtimin e shqetësimeve etike.

50 Fokus grup me gazetarë të transmetimeve, OJQ-ve dhe mediave online, realizuar nga Getoarbë Mulliqi më 29.12.2023.

51 Po aty.

52 IREX, [Vibrant Barometer Information 2023](#).

53 IREX, [Vibrant Barometer Information 2023](#).

54 Getoarbë Mulliqi, Anketa me 212 gazetarë kosovarë, 2023.

Megjithatë, nuk janë identifikuar rregulla të tjera organizative për ta mbajtur redaksinë të pavarur nga organet drejtuese⁵⁵.

Kur bëhet fjalë për format më të zakonshme të presionit që qeveria bën për redaksitë e RTK-së, ndër to janë edhe shkurtime të buxhetit. Disa gazetarë argumentojnë se trysnia e qeverisë po prek drejtpërdrejt organet menaxheriale dhe jo gazetarët. Kjo është e evidente përmes një reduktimi tjetër buxhetor që i është bërë RTK-së nga qeveria. Në vitin 2021, RTK-ja ka marrë buxhet prej 11.2 milionë euro, por për vitin 2024 është vendosur që ky buxhet të zvogëlohet për 2.2 milionë. Në këtë rast, RTK-ja bëhet më e prirur ndaj presioneve politike për shkak të varësisë së saj nga fondet publike. Flutura Kusari thekson se ky është buxheti më i ulët që ka marrë RTK-ja në dekadën e fundit⁵⁶.

Më 4 shkurt 2023, AGK-ja, në bashkëpunim me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë, shprehën shqetësimin për emërimin e Rilind Gërvallës në postin e drejtorit të televizionit publik. Sipas AGK-së, zgjedhja e Gërvallës, duke pasur parasysh lidhjen e tij me Vetëvendosjen, përbën konflikt interesi dhe cenon rëndë pavarësinë e televizionit publik⁵⁷.

— B.4 PAVARËSIA EDITORIALE NË SEKTORIN E MEDIAVE JOFITIMPRURËSE

Sektori i mediave jofitimprurëse në Kosovë ka përjetuar një zgjerim, por nuk është aq i madh në krahasim me sektorin privat. Nuk ka asnjë regjistër që pasqyron numrin e saktë të mediave jofitimprurëse; megjithatë, BIRN & Kallxo.com, K2.0, Betimi për Drejtësi janë disa nga mediat online jofitimprurëse më të spikatura në Kosovë. Besohet se kjo rritje ka ndodhur për faktin se mediat e regjistruara si biznese, pra mediat e sektorit privat po përballen me vështirësi të mëdha financiare, ndërsa organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të aplikojnë për grante, mbështetje institucionale dhe thirrje të hapura ndërkombëtare.

Në krahasim me sektorin privat, të gjitha mediat më të mëdha jofitimprurëse në Kosovë kanë miratuar kode të brendshme të sjelljes. Për më tepër, BIRN ka statutin e tij që është jofitimprurës.

Vitet e fundit, me kalimin nga media e shkruar në atë online, gazetarët shpesh ankohen për kufizimet kohore dhe nevojën për të publikuar shpejt shumë artikuj. Disa vërejnë gjithashtu presionin për të gjeneruar klikime, duke çuar në renditje jozyrtare bazuar në shpeshtësinë dhe popullaritetin e publikimeve⁵⁸. Ky theksim i klikimeve është bërë standard në mediat online, duke rezultuar shpesh në më pak raportime në terren nga shumë gazetarë, përveç nëse ata krijojnë gjithashtu përmbajtje audio-vizuale.

55 Fokus grup me gazetarë të transmetimeve, OJQ-ve dhe mediave online, realizuar nga Getoarabë Mulliqi më 29.12.2023.

56 "[Kusari tregon recetën për shkatërrimin e RTK-së nga partitë politike, thellësisht e zhgënjyer](#)" (Kusari tregon recetën për shkatërrimin e RTK-së nga partitë politike, thellësisht e zhgënjyer) Nacionale, 2023.

57 AGK, [Proces i ri për zgjedhjen e drejtorit të televizionit të RTK-së](#), 2023.

58 Fokus grup me gazetarë të transmetimeve, OJQ-ve dhe mediave online, realizuar nga Getoarabë Mulliqi më 29.12.2023.

— B.5 LIRIA E GAZETARËVE NË PROCESIN E PRODHIMIT TË LAJMEVE

Shtrirja e lirisë që gazetarët pretendojnë se kanë në procesin e prodhimit të lajmeve është disi e kufizuar⁵⁹. Ndërsa ata argumentojnë se ndjehen të lirë të propozojnë një storie, ata shpesh hezitojnë kur bëhet fjalë për të vendosur perspektivën nga e cila do të mbulohet historia. Gazetarët priren të përmbahen nga miratimi i një qëndrimi kritik, duke treguar se ekziston një praktikë e vetëcensurës. Ky fenomen, i karakterizuar nga një hezitim për të kaluar në këndvështrime kritike, është veçanërisht i pranishëm në mesin e gazetarëve që bëhen pjesë e mediave të veçanta me përshtypjen se media të tilla anojnë nga biznesmenët që përdorin këto media si platformë për marketing.

Gazetarët ndikohen më së shumti nga faktorë brenda redaksisë, si autocensura, që ata mendojnë se fillon kur fillojnë të punojnë në media. Ata janë të vetëdijshëm se çfarë temash shmangin të diskutojnë. Kur bëhet fjalë për ndikimet e jashtme, shumica e gazetarëve në anketë thonë se nuk janë të prekur nga presioni publik, edhe nëse janë përballur me kritika nga grupe të ndryshme si politikanë apo biznesmenë. Në kushte anonimiteti, gazetari M.B. i cili ka ndërruar tri herë vendin e punës (media) gjatë vitit 2023, thotë se problemet më të mëdha vijnë nga pronarët e mediave që janë biznesmenë dhe nuk e njohin dhe kuptojnë natyrën e punës në sektorin e mediave⁶⁰. Presioni nuk ka ardhur direkt nga redaktorët apo kryeredaktorët, por është bërë nga direktivat e pronarëve që nuk e kuptojnë profesionin dhe përgjegjësitë e gazetarëve.

Gazetarët në Kosovë pohojnë se autocensura është një nga çështjet me të cilat ballafaqohen në punën e tyre të përditshme, por kjo nuk duket të jetë problem duke qenë se ka pluralizëm mediatik dhe për shkak të krijimit të një numri të madh të mediave të reja në vend, ata nuk rrezikojnë të mos gjejnë një vend tjetër pune⁶¹. Pothuajse njëzëri gazetarët e fokus grupit u shprehën se në të gjitha mediat gazetarëve u kërkohet të censurojnë veten, madje të përmbahen nga postimet në rrjetet e tyre sociale⁶². Ndërsa mbi 35% e të anketuarve në anketë nuk e pranojnë se janë të vetëcensuruar, pjesa tjetër nuk janë të vetëdijshëm nëse censurohen dhe shumica pranojnë se ka censurë⁶³. Në krahasim me vitet e kaluara, shumica e gazetarëve janë vetëdijshëm për vetëcensurën si rezultat i censurës së ushtruar ose nga eprorët e tyre ose "censurës së heshtur" të imponuar ndaj tyre nga departamentet e marketingut brenda mediave të tyre.

— B.6 POZITA E PUNËS SË GRAVE GAZETARE

Jo vetëm që kushtet e punës për gratë gazetare nuk janë përkeqësuar, por ekziston një perceptim se pozitat e tyre janë përmirësuar, duke tejkaluar ato të burrave me kalimin e viteve⁶⁴.

59 Fokus grup me gazetarë të transmetimeve, OJQ-ve dhe mediave online, realizuar nga Getoarbë Mulliqi më 29.12.2023.

60 M.B. gazetar i intervistuar nga Getoarbë Mulliqi më 07.01.2024

61 Fokus grup me gazetarë të transmetimeve, OJQ-ve dhe mediave online, realizuar nga Getoarbë Mulliqi më 29.12.2023.

62 Po aty.

63 Getoarbë Mulliqi, Anketa me 212 gazetarë kosovarë, 2023.

64 Peaceful Change Initiative. "[Kosovë: Raporti i Vlerësimit të Nevojave të Infrastrukturës Lokale](#)", mars 2023.

Sipas bazës së të dhënave të AGK-së, ku mbi 65% e anëtarëve janë gra, vërehet mungesë e diskriminimit me bazë gjinore, si për sa u përket kushteve të punës ashtu edhe të ardhurat janë disi të barabarta, por gratë janë ende të diskriminuara kur bëhet fjalë për pushimin e lehonisë dhe diskriminime të tjera bazuar në gjini si dhe përballen me ngacmime më shumë se meshkujt.

Një ndryshim pozitiv ka ndodhur pasi gazetarët në fokus grup kanë deklaruar se më shumë pozita menaxheriale u janë besuar grave se në vitet e mëparshme⁶⁵. Shumica e gazetarëve që raportojnë nga terreni në shumicën e rrjeteve televizive kosovare janë gra⁶⁶. Shumica e redaktorëve janë gra, dhe numri i grave dhe burrave në pozita udhëheqëse në media perceptohet i barabartë me RTV21 që është në pronësi të grave. Megjithatë, sipas anketës së Grave në Media në Kosovë, është ende e vështirë të konkludohet nëse gratë përballen me shanse të mëdha si tavani i qelqtë në vendet e punës në media për shkak të mungesës së të dhënave statistikore për pozitat udhëheqëse editoriale në mënyrë që të shihet nëse ka ndonjë pabarazi në pozicionet drejtuese⁶⁷.

Një nga shqetësimet më serioze që mund të gjendet në një hulumtim të Kosova 2.0 për gratë gazetare⁶⁸ është ngacmimi seksual. Anketa vlerëson se 26,4 % e 265 të anketuarave kanë përjetuar ngacmime seksuale në redaksi. Për më tepër, lehtësimi i balancës punë-jetë për nënat në gazetari është thelbësor për një mjedis mediatik më gjithëpërfshirës dhe të larmishëm⁶⁹.

65 Fokus grup me gazetarë të transmetimeve, OJQ-ve dhe mediave online, realizuar nga Getoarbë Mulliqi më 29.12.2023.

66 Po aty.

67 Peaceful Change Initiative. "[Anketa e Grave në Media në Kosovë](#)", mars 2023.

68 [Barra-e-padukshme-e-gazetareve](#), prill 2023.

69 Po aty.

C. SIGURIA E GAZETARËVE

— C.1 GAZETARËT DHE AKTORËT E MEDIAVE KANË QASJE NË MASAT MBROJTËSE TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE KUR KËRCËNOHEN

Policia e Kosovës është i vetmi institucion publik përmes të cilit gazetarët apo të gjithë individët mund të raportojnë incidente të gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve serioze për jetën e tyre. Incidente të tilla mund të raportohen ose me telefon ose me email. Madje, si Policia ashtu edhe Prokuroria kanë caktuar një koordinator për t'u marrë me rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Gazetarët raportojnë rastet në të njëjtën mënyrë si çdo qytetar tjetër.

Përveç Policisë së Kosovës, një adresë tjetër ku gazetarët tentojnë të raportojnë gjuhën e urrejtjes dhe rastet e rënda me rrezik për jetën është edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, i cili në shumicën e rasteve është pika e tyre kryesore e kontaktit dhe madje adresa kryesore ku i raportojnë rastet e tyre. Bazat e të dhënave të AGK-së dhe PK-së kanë mospërputhje, pasi gazetarët prirën të mos i raportojnë të gjitha rastet si në AGK ashtu edhe në PK. Gazetarët kanë raportuar gjithsej 31 raste në PK, ndërsa 74 raste janë raportuar në AGK⁷⁰.

Deri në fund të vitit 2023, 11 nga rastet e raportuara në PK ishin nën hetim, ndërsa 20 raste janë referuar në Prokurori. PK konsiderohet institucioni më efektiv në hetimin e rasteve kundër gazetarëve. Nuk ka raste të njohura të autoriteteve përkatëse që nuk përgjigjen ose refuzojnë të përpunojnë/pranojnë raporte nga gazetarët ose organet e mediave në lidhje me shkeljet e të drejtave të tyre.

— C.2 GAZETARËT DHE AKTORËT E TJERË TË MEDIAS (JETA OSE INTEGRITETI FIZIK I TË CILËVE JANË NË RREZIK REAL DHE TË MENJËHERSHËM) KANË QASJE NË MEKANIZMA TË VEÇANTË MBROJTJEJE/SIGURIE

Ekzistojnë dispozita ligjore në sistemin juridik, veçanërisht në Kodin Penal të Republikës së Kosovës i cili ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019. Kështu, këto masa mbrojtëse mbrojnë çdo person që mund të jetë viktimë e një veprë penale, duke përfshirë edhe gazetarët. Megjithatë, nuk ka mekanizma specifike të zhvilluar nga institucionet shtetërore që synojnë të mbështesin veçanërisht sigurinë e gazetarëve.

Në Kosovë, mungesa e një procedure sistematike të vlerësimit të rrezikut për gazetarët dhe mbrojtjen e qytetarëve tregon një boshllëk potencial në garantimin e sigurisë së tyre. Vendosija e një procedure të tillë është e rëndësishme për identifikimin e kërcënimeve specifike dhe formulimin e strategjive efektive zbutëse.

70 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Baza e të dhënave të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. Kosovë, 2023.

— C.3 GAZETARET FEMRA KANË QASJE NË MASAT LIGJORE DHE MEKANIZMAT MBËSHTETËS KUR PËRBALLEN ME KËRCËNIME, NGACMIME DHE DHUNË ME BAZË GJINORE

Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se tetë instrumente ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Stambollit, janë të garantuara dhe zbatohen drejtpërdrejt në vend dhe, në rast konflikti, kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Më 25 shtator 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes amendamenteve kushtetuese, ka inkorporuar Konventën e Stambollit në këtë listë të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Me zbatimin e kësaj konvente lindi disa detyrime për çdo shtet. Sipas nenit 5 të Konventës, paragrafi 1, "palët do të përmbahen nga përfshirja në çdo akt dhune ndaj grave dhe do të sigurojnë që autoritetet shtetërore, zyrtarët, agjentët, institucionet dhe aktorët e tjerë që veprojnë në emër të shtetit të veprojnë në përputhje me këtë detyrim"⁷¹. Për më tepër, paragrafi 2 i të njëjtit nen, thekson dhe detyron që të hetojnë, ndëshkojnë dhe sigurojnë dëmshpërblim për aktet e dhunës të mbuluara nga fushëveprimi i kësaj Konvente, të kryera nga aktorë joshtetërorë⁷². Gjithashtu, neni 7 i Kushtetutës garanton barazinë gjinore si vlerë themelore. Dhuna me bazë gjinore njihet si formë e diskriminimit sipas Ligjit për Barazi Gjinore.

Janë krijuar mekanizma shtetërorë për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Në kuadër të Prokurorisë së Shtetit funksionon Zyra për Mbrojtjen e Viktimave e cila gjithashtu përfaqëson rastet e dhunës në baza gjinore, ndërsa në kuadër të Agjencisë për ndihmë juridike falas, ndihma juridike falas u ofrohet viktimave të dhunës në bazë gjinore kur viktimat nuk janë në gjendje të paguajnë atë. Ekziston edhe Institucioni i Avokatit të Popullit ku viktimat mund të kërkojnë ndihmë. Rregullimet ekzistuese institucionale vlejné edhe për gazetaret. Gjithashtu, nuk ofrohet mbështetje e veçantë ligjore për gazetaret femra në raportimin e këtyre rasteve.

Në bazë të informatave të mbledhura nga AGK-ja lidhur me raportimin e rasteve të gazetarëve femra brenda institucioneve, është konstatuar se institucionet janë të përgjegjshme. Përveç kësaj, gazetaret femra kanë qasje në të njëjtat masa ligjore dhe mekanizma mbështetës si edhe bashkëqytetarët e tyre femra. Megjithëse gazetaret femra besojné se dallimet në bazë gjinore nuk ekzistojné në mënyrën se si institucionet i trajtojnë rastet e tyre, natyra e kërcënimeve me të cilat përballen sugjerojnë se ato kanë më shumë gjasa të synohen në një nivel personal dhe jo vetëm profesional, siç shihet në rastet që përfshijnë gazetaret meshkuj. Në AGK janë raportuar 11 sulme ndaj gazetarëve femra, 17 sulme ndaj gazetarëve meshkuj dhe 46 sulme ndaj grupeve dhe ekipeve mediale⁷³.

71 Këshilli i Evropës. "[Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje](#)" H(1995)010. Strasburg: Këshilli i Evropës, 1995.

72 Po aty.

73 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Baza e të dhënave të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. Kosovë, 2023.

— C.4 ËSHTË VENDOSUR PRAKTIKA E DËNIMIT TË RREGULLT PUBLIK TË KËRCËNIMEVE DHE SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE MEDIAVE

Institucionet qeveritare i njohin sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve si shkelje të lirisë së shprehjes, ligjit për të drejtat e njeriut dhe ligjit penal. Megjithatë, ato ofrojnë mbështetje të kufizuar publike për gazetarët. As institucionet shtetërore dhe as shumica e partive politike me ndikim nuk kanë krijuar praktika për të dënuar vazhdimisht rastet e sulmeve dhe kërcënimeve të tjera ndaj gazetarëve. Përveç kësaj, qeveria ka ndërmarrë masa minimale për të kundërshtuar narrativat negative ndaj gazetarëve.

Zyrtarët publikë zakonisht përmbahen nga dhënia e deklaratave nëse nuk ka pasur sulme të rënda fizike kundër gazetarëve. Deklarata të tilla nuk janë pjesë e rregullt e komunikimit të tyre, por bëhen vetëm në rastet kur ndodhin sulme fizike. Deklaratat e tyre shpesh kërkojnë dënimin e autorëve, por ato nuk trajtojnë rastet që përfshijnë gjuhë nënçmuese nga politikanë apo zyrtarë publikë/shtetërorë.

Siç është regjistruar në bazën e të dhënave të AGK-së, 16 nga 74 rastet që kanë ndodhur gjatë vitit 2023 përfshijnë personazhe publike, zyrtarë të rangut të lartë dhe individë të lidhur me këta aktorë në Kosovë. Sipas të anketuarve të grupit të fokusit, në përgjithësi, ata ndihen të sigurt dhe mjedisi nuk perceptohet si shumë i ashpër⁷⁴. Megjithatë, perceptohet se hetimet lidhur me zyrtarë publikë, zyrtarë të rangut të lartë ose individë me ndikim në politikë priren të tërheqin kërcënime dhe fushata denigruese⁷⁵.

— C.5 AUTORITETET POLICORE JANË TË NDJESHME NDAJ ÇËSHTJEVE TË MBROJTJES SË GAZETARËVE

Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) ofron “Kurse për të Drejtat e Njeriut” që mbulojnë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Të drejtat ndërkombëtare të njeriut janë të integruara në trajnimin profesional të policisë, me tema mediatike të përfshira në nivel menaxherial dhe në trajnimin zyrtar të policisë. Policia e Kosovës (PK) ka bërë përpjekje që të organizojë trajnime për marrëdhënie me media për zyrtarët policorë. Për më tepër, Departamenti për Siguri Publike në kuadër të Misionit të OSBE-së në Kosovë ka organizuar, mbështetur dhe financuar disa programe trajnimi për policët në të gjitha rajonet e Kosovës. Në përgjithësi, ndërsa këto përpjekje kanë kontribuar në përmirësimin e njohurive të punonjësve të policisë, ekziston ende nevoja për trajnime të mëtejshme për të siguruar që policët të jenë të arsimuar dhe të njohur me standardet bazë ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe rolin e gazetarëve në një shoqëri demokratike⁷⁶.

74 Fokus grup me gazetarë të transmetimeve, OJQ-ve dhe mediave online, realizuar nga Getoarbë Mulliqi më 29.12.2023.

75 Po aty.

76 OSBE (datë 2024, shkurt), Intervistë me OSBE-në në Zyrën e Komunikimit në Kosovë.

Policia e Kosovës (PK) ka zbatuar udhëzimet dhe protokollet kundër akteve të ngacmimit, frikësimit apo sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Gjithashtu ka caktuar një koordinator për të monitoruar dhe trajtuar të gjitha rastet për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e gazetarëve. Për më tepër, PK-ja është në bashkëpunim të ngushtë me organe të tjera të rëndësishme, siç janë organizatat e mediave dhe organizatat e shoqërisë civile, për t'u siguruar që të trajtojnë në mënyrë efektive çdo incident të ngacmimit, frikësimit apo sulmit fizik ndaj gazetarëve.

Në vitin 2023, një grup gazetarësh, si dhe një kameraman, u penguan dhe u hodh gaz lotsjellës nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës (PK) teksa mbulonin një protestë në Prishtinë. AGK-ja ka njoftuar Inspektoratin Policor të Kosovës dhe janë marrë masa të menjëhershme për identifikimin e zyrtarëve policorë të përfshirë. Megjithatë, nuk ka pasur asnjë rast të raportuar të gazetarëve që i janë nënshtruar ndalimit të nëndheshëm nga policia gjatë periudhës raportuese.⁷⁷

Sipas AGK-së, Policia e Kosovës (PK) veçohet si institucioni më bashkëpunues. Përveç pikës së caktuar të kontaktit në kuadër të PK-së, AGK-ja ka lirinë të kontaktojë edhe zyrën për informim dhe marrëdhënie me publikun e këtij institucioni për rastet që kanë të bëjnë me gazetarët. AGK-ja monitoron vazhdimisht rastet e gazetarëve çdo gjashtë muaj dhe sipas nevojës⁷⁸.

— C.6 NJËSITË E SPECIALIZUARA TË HETIMIT DHE/ OSE OFICERËT JANË TË PAJISUR ME EKSPERTIZËN PËRKATËSE PËR HETIMIN E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE

Ka punonjës të veçantë si në polici ashtu edhe në prokurori, dhe prokurori i shtetit i jep prioritet rasteve që përfshijnë gazetarë, veçanërisht ato ku gazetarët janë viktima. Brenda të gjitha prokurorive ka prokurorë përgjegjës dhe koordinatorë të I.E. AGK-ja monitoron të gjitha rastet që kanë të bëjnë me gazetarët në baza gjashtëmujore dhe punon ngushtë me përfaqësuesit e prokurorisë, policisë dhe KGJK-së për të harmonizuar bazat e tyre të të dhënave. Megjithatë, brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës, mungon një njësi e dedikuar e fokusuar vetëm në hetim, ndjekje penale dhe mbrojtje lidhur me sigurinë e gazetarëve⁷⁹. Përveç kësaj, koordinatorët brenda institucioneve të sundimit të ligjit luajnë rol jetik në monitorimin e punës së prokurorëve në rastet që përfshijnë gazetarë⁸⁰.

Në Kosovë, institucionet nuk ndajnë mjaftueshëm burime për hetime apo nuk ofrojnë masa adekuate për mbrojtjen e gazetarëve. Megjithatë, në vitin 2023 është në proces themelimi një dialog i iniciuar nga AGK-ja dhe institucionet e sundimit të ligjit. Përmes këtij dialogu do të përmirësohen kapacitetet e zyrtarëve nga të gjitha institucionet dhe synohet të krijohet një mekanizëm i veçantë⁸¹.

77 Beka, Arbër. "Intervistë me Arbër Bekën – Shef i Divizionit për Marrëdhënie me Publikun dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar". 1 shkurt 2024.

78 Rexha, XH. (1 shkurt 2024). Intervistë me Xhemajl Rexha – Kryetar i Bordit të AGK-së.

79 Kozmaqi, L. "Kërkesë për të dhëna." Shefe e Zyrës për Komunikim Publik, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 2 shkurt 2024.

80 Po aty.

81 Zekaj, Ylli. "Intervistë me Ylli Zekaj – avokat." 2 shkurt 2024.

Gjatë gjithë vitit 2023 janë mbajtur disa takime të mbyllura ndërmjet përfaqësuesve të AGK-së, KPK-së dhe KGJK-së. Objektivi i këtyre takimeve ishte krijimi i një mekanizmi për prioritizimin e rasteve që përfshijnë gazetarë, me fokus parësor krijimin e një sistemi monitorimi për kërcënimet dhe sulmet kundër gazetarëve.

— C.7 HETIMET E SULMEVE TË RËNDA FIZIKE NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE KRYHEN ME EFIKASITET (NË MËNYRË TË PAVARUR, TËRËSISHT DHE MENJËHERË).

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) monitoron punën e policisë, prokurorisë dhe gjykatave në trajtimin e sulmeve, kërcënimeve, gjuhës së urrejtjes dhe veprave të tjera penale kundër gazetarëve. Sipas IKD-së, gjatë vitit 2023, gazetarët në Kosovë i janë nënshtruar dhunës sistematike nga politikanët, kryesisht nga partia politike në pushtet, si dhe nga individë që e mbështesin publikisht atë parti⁸². Në disa raste përgjegjës kanë qenë edhe qytetarët e thjeshtë apo grupet kriminale në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Numri i lëndëve penale të proceduara në vitin 2023 është shumë i vogël në krahasim me sasinë e konsiderueshme të kërcënimeve digjitale dhe llojeve të tjera të dhunës ndaj gazetarëve të raportuara në media.

Përmes një projekti të mbështetur nga Ambasada Holandeze në Prishtinë, IKD ka për obligim, ndër të tjera, të ofrojë ndihmë juridike falas për gazetarët që janë viktime të krimit dhe që i nënshtrohen aktakuzave për shpifje. Ata gjithashtu analizojnë aktakuzat dhe vendimet e gjykatës kur gazetarët janë viktime të krimit. Analiza e IKD-së për aktgjykimet dhe aktakuzat e gjykatave zbulon se hetimet nuk kryhen në mënyrë profesionale dhe politikat e dënimit janë të ulëta⁸³. Prokuroria i fokuson hetimet kryesisht te kryesi i veprës penale. Dënimet e shqiptuara nga gjykata përgjithësisht përbëhen nga gjoba, lirim me kusht dhe shumë rrallë burgim efektiv. Për më tepër, sipas Imer Mushkolajt, hetimet shpesh ndikohen nga aktorë të ndryshëm, duke mos marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante si bazë⁸⁴.

Edhe pse Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit i ka dhënë prioritet të lartë trajtimit të veprave penale, praktika tregon se prokuroritë rrallëherë i përmbahen udhëzimeve të tilla. Si policisë ashtu edhe prokurorëve shpesh u mungon përvoja dhe ekspertiza e nevojshme profesionale për të kryer hetime të plota dhe të aftë dhe për të përfaqësuar në mënyrë efektive rastet në gjykatë⁸⁵. Më tej, Mushkolaj thekson se hetimet shpeshherë i nënshtrohen zvarritjeve të konsiderueshme, duke rezultuar që rastet të mbeten të pazgjidhura në kohë dhe të vështirësohet edhe më shumë puna e gazetarëve.

Sipas Miftarajt, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës parasheh afate dhe procedura të qarta për trajtimin e të gjitha rasteve penale nga policia, prokuroria dhe gjykatat. Megjithatë, sulmet

82 Miftaraj, Ehat. "Intervistë me Ehat Miftaraj – Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD)." 2 shkurt 2024.

83 Po aty.

84 Mushkolaj, Imer. "Intervistë me Imer Mushkolaj – Drejtor Ekzekutiv i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës". 2 shkurt 2024.

85 "Intervistë me Ehat Miftaraj – Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD)." 2 shkurt 2024.

dhe kërcënimet ndaj gazetarëve në Kosovë nuk vlerësohen në mënyrë konsistente në përputhje me peshën e veprës penale siç thuhet në Kodin Penal. Kjo vjen si pasojë e dështimit të policisë dhe prokurorisë për të kryer hetime dhe ndjekje të hollësishme dhe profesionale për raste të tilla. Sulmet ndaj gazetarëve shpesh nuk marrin përparësinë e nevojshme dhe dënimet për ata që janë përgjegjës për sulme të tilla nuk përputhen me ashpërsinë e veprës penale të kryer. Kjo mungesë e përgjigjes së duhur inkurajon autorët e mundshëm që të veprojnë kundër gazetarëve pa frikë nga pasoja të mëdha.

— C.8 GAZETARËT DHE AKTORËT E TJERË TË MEDIAVE MBROHEN NË MËNYRË EFIKASE NGA FORMA TË NDRYSHME TË NGACMIMEVE NË INTERNET.

Dispozitat e përgjithshme lidhur me ngacmimin bien nën Kodin Penal të Kosovës, Kodi Nr. 06/L-074. Për më tepër, rastet e shpifjes, fyerjes dhe ofendimeve kundër reputacionit dhe sigurisë së gazetarëve mund të aplikohen në rastet e ngacmimeve në internet. Për më tepër, nëse një shembull i ngacmimit online përfshin përpunimin e paautorizuar të të dhënave personale të gazetarëve, ai mund të adresohet sipas rregulloreve të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-172, i cili ka të bëjë me Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu, nëse ngacmimi në internet përfshin elemente të diskriminimit në bazë të racës, përkatësisë etnike, gjinisë, fesë ose karakteristikave të tjera të mbrojtura, zbatohet ligji i posaçëm për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjithashtu, ngacmimi seksual rregullohet me Kodin Nr. 06/L-074 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, veçanërisht nenet 182 dhe 183⁸⁶.

Në vitin 2023, baza e të dhënave e AGK-së dokumentoi 10 raste të ngacmimeve dhe kërcënimeve online ndaj gazetarëve. Këto kërcënime u kryen kryesisht përmes platformave të mediave sociale, duke përfshirë postimet publike dhe mesazhet private drejtuar gazetarëve ose llogarive të tyre në mediat sociale⁸⁷. Rastet përfshinin një sërë individësh, duke përfshirë qytetarë, aktivistë politikë, madje edhe zyrtarë publikë, të përfshirë në ngacmime në internet, fushata shpifjeje dhe kërcënime të drejtpërdrejta. Një rast i dukshëm përfshinte Burim Pacollin nga Nacionale, i cili jo vetëm u ngacmua në mesazhe private, por u përball edhe me kërcënime të drejtpërdrejta përmes një storie në Instagram ku një individ kërkoi publikisht adresën e shtëpisë së tij⁸⁸. Një tjetër gazetar, Fatlum Berisha, mori një kërcënim me vdekje në faqen e tij në TikTok, ku kryesi deklaroi se duhej të qëllohej 31 herë⁸⁹.

Një çështje që lind është mungesa e masave të mjaftueshme të ndërmarra nga institucionet për të adresuar kërcënimet online ndaj gazetarëve. Një hetim i kryer nga Betimi për Drejtësi zbuloi se në shumicën e rasteve të ngacmimeve online ndaj gazetarëve, pasojat përfshijnë vetëm gjoba, që variojnë nga 250 deri në 500 euro. Kjo tregon domosdoshmërinë e

86 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, [Kodi Penal i Republikës së Kosovës](#),

87 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Baza e të dhënave të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. Kosovë, 2023.

88 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Kërcënim i ndaj gazetarit Burim Pacolli, Prishtinë, 14.12.2023](#)".

89 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Kërcënohet me vdekje gazetari Fatlum Berisha](#)".

masave dhe pasojave më të forta për të penguar një sjellje të tillë dhe për të mbrojtur gazetarët nga kërcënimet online.

— C.9 HETIMET PËR TË GJITHA LLOJET E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE KRYHEN NË MËNYRË TRANSPARENTE

Gjykatat janë të detyruara të japin informacion për viktimat, siç kërkohet me ligj. Për shembull, Kodi i Procedurës Penale Nr. 08/L-032, konkretisht neni 63 e përshkruan këtë detyrim⁹⁰. Në përputhje me dispozitat e këtij neni, viktimat kanë të drejtë në informim me kohë dhe të menjëhershëm nga policia, prokurori i shtetit apo organet tjera kompetente të përfshira në procedurë (Kodi nr. 08/L-032 Kodi i Procedurës Penale⁹¹). Për më tepër, viktimat gjithashtu ka të drejtë të kërkojë mbështetje nga Zyra për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave e cila është themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Krahas ofrimit të mbështetjes profesionale për viktimën e krimit, kjo zyrë është e detyruar t'i kërkojë gjykatave dhe prokurorisë që të respektojnë dhe mbrojnë të drejtat e viktimës gjatë gjithë procesit ligjor.

Megjithatë, gjykatat shpesh dështojnë të ofrojnë informacionin e nevojshëm për rastet e gazetarëve dhe niveli i transparencës në procedurat ligjore lidhur me sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave është i pamjaftueshëm. Përfaqësuesit e AGK-së u takuan me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe ata ishin të hapur për të bashkëpunuar dhe për të gjetur modalitete për mbledhjen dhe prioritizimin e të dhënave që ndikojnë në sigurinë e gazetarëve.

Nuk ka dëshmi se ndonjë gazetar ka kërkuar ndihmë nga Zyra për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave e cila është e themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Sipas informatave në fjalë, prokurorët e shtetit në Kosovë pothuajse nuk e njoftojnë publikun apo mediat për ndonjë fazë të procedurës penale dhe as zakonisht nuk lejojnë qasje në shkresat e lëndës. Në bazë të të dhënave të prokurorit ose gjyqtarit, përkatësisht, zëdhënësja e secilës prokurori dhe zyrë gjyqësore informon publikun për statusin e lëndës. Gazetarëve u jepet qasje e pakufizuar dhe jodiskriminuese në seancat gjyqësore, me përjashtim të rasteve që kanë të bëjnë me urdhrat e mbrojtjes nga gjyqtarët.

— C.10 SISTEMET E GRUMBULLIMIT TË STATISTIKAVE CILËSORE TË KRIJUARA NGA AUTORITETET SHTETËRORE PËR TË FRENUAR MOSNDËSHKIMIN

Për qëllime të këtij raporti, AGK-ja ka dërguar e-mail zyrtar në Gjykatën Supreme, duke kërkuar informacione. Përgjigja e marrë nga Gjykata Supreme tregonte se ata nuk posedojnë të dhëna statistikore të regjistruara nga autoritetet shtetërore. Kjo pasi të dhëna të tilla zotërohen edhe nga policia dhe

90 GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS. (2022). [KODI NR. 08/L-032 KODI I PROCEDURËS PENALE](#).
91 Po aty.

prokuroria⁹². Bazuar në të dhënat e dhëna nga Gjykata Supreme, informacioni është pjesërisht i zbërthyer. Të dhënat përfshijnë detaje mbi procedurat gjyqësore në lidhje me gazetarët, si numri i ankesave të raportuara, hetimet e hapura, ndjekjet penale dhe dënimet. Megjithatë, nuk ka një klasifikim specifik që dallon nëse këto raste përfshijnë kërcënime, sulme kundër ose vrasje të gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave⁹³. Informacionet dhe të dhënat e marra nga intervista me përfaqësuesin e Gjykatës Supreme në lidhje me rastet e gazetarëve dhe procedurat e tyre tregojnë se të dhënat nuk janë zbërthyer në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike dhe kriterëve të tjera socio-demografike⁹⁴.

Në korrespondencë me ushtruesin e detyrës së Shefit të Njesisë për Komunikim Publik në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, janë siguruar informata dhe të dhëna të detajuara për veprat penale të dhunës ndaj gazetarëve për vitin 2023. Bazuar në informacionin e dhënë, u pa se të gjitha rastet e regjistruara ishin trajtuar⁹⁵. Të dhënat e ofruara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës ishin tërësisht të zbërthyera. Informacioni mbi procedurat gjyqësore në lidhje me gazetarët përfshinte detaje mbi numrin e ankesave të raportuara, hetimet e hapura, ndjekjet penale dhe dënimet në lidhje me rastet e gazetarëve. Për më tepër, rastet u klasifikuan, për shembull, në kategori të tilla si frikësimi, ngacmimi, sulmi, lëndimi i lehtë trupor dhe lëndimi i rëndë trupor⁹⁶.

Për ta shtuar më tej këtë çështje, është e rëndësishme të theksohet se gjykatat dhe institucionet e tjera shpesh nuk ofrojnë të dhëna të detajuara në lidhje me rastet që përfshijnë gazetarë në Kosovë. Prandaj, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka realizuar intervista me disa media në Kosovë për të mbledhur më shumë informacione për raste të tilla. Kallxo.com bën të ditur se kanë më shumë se 13 padi me persona apo kompani të ndryshme. Kjo situatë është edhe pasojë e natyrës së Kallxo.com si media hulumtuese⁹⁷.

— C.11 KËRCËNIMET DHE NGACMIMET JO-FIZIKE

Në vitin 2023 në bazën e të dhënave të AGK-së janë regjistruar gjithsej 20 raste. Ky numër është rritur me një në krahasim me një vit më parë⁹⁸. Megjithatë, pavarësisht se nuk përfaqësojnë një ndryshim të rëndësishëm në numër, ashpërsia dhe shpeshësia e këtyre kërcënimeve janë rritur. Për më tepër, numri i rasteve të raportuara nuk pasqyron shkallën e vërtetë të kërcënimeve dhe ngacmimeve jo-fizike, pasi gazetarët mund të hezitojnë të raportojnë të gjitha rastet, veçanërisht ato që përfshijnë ngacmime në internet.

Në AGK nuk është raportuar asnjë rast vëzhgimi apo gjurmimi. Gjithashtu, të anketuarit thonë se nuk janë

92 Uka, A. "Kërkesë për të dhëna." 1 shkurt 2024.

93 Po aty & Uka, A.U. "Kërkesë për të dhëna." 1 shkurt 2024.

94 Po aty.

95 Gashi, B. G. "Kërkesë për të dhëna." 2 shkurt 2024.

96 Po aty & Gashi, B. G. "Kërkesë për të dhëna." 2 shkurt 2024.

97 Leposhtica, Labinot. "Intervistë me Labinot Leposhticën – Koordinator i Monitorimit të Gjykatave dhe Zyrës Ligjore të BIRN Kosovës". Intervistuar nga Getoarbë Mulliqi. 16 janar 2024.

98 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Baza e të dhënave të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. Kosovë, 2023.

në dijëni për ndonjë rast të tillë ndaj gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të mediave në të kaluarën.

Në vitin 2023, gazetarja Erjola Cacaj nga Portali Nacionale mori kërcënime nga një kompani që kishte fituar një tender në Kosovë. Ngjarja ka ndodhur teksa ajo ishte duke hulumtuar një tender në komunën e Podujevës. Pronari i një kompanie me seli në Prizren, i cili ishte ofertuesi fitues, bëri thirrje telefonike kërcënuese ndaj gazetarëve të Nacionale. Ky është i vetmi rast i regjistruar i telefonatave ngacmuese gjatë vitit 2023⁹⁹.

Asnjë rast i ngacmimit arbitrar gjyqësor apo administrativ nuk është raportuar apo identifikuar gjatë vitit 2023¹⁰⁰.

Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla, përdori gjuhë të rrezikshme dhe të papranueshme ndaj mediave dhe gazetarëve. Ai ka thënë se audio-incizimet e kryetares së Grupit Parlamentar të partisë së tij, Mimoza Kusari Lila, me ish-deputetin e Srpska-s, Simiq, i ka dhënë mediave kosovare presidenti serb, Vuçiq¹⁰¹. Po ashtu, deputeti i partisë në pushtet, Mefail Bajqinovci, ka zbuluar dokumente të brendshme të Administratës Tatimore të Kosovës për të diskredituar gazetarët dhe pronarin e Nacionales, Berat Buzhala. Bajqinovci tha se ky i fundit kishte shmangur tatimet¹⁰².

Kur Ministria e Tregtisë tentoi t'ia heq licencën Televizionit Klan Kosova, gazetarët protestuan gjatë një konference për media të udhëhequr nga ministrja Rozeta Hajdari¹⁰³. Të gjithë gazetarët pjesëmarrës kolektivisht bojkotuan konferencën. Pas kësaj, një fushatë shpifëse kishte në shënjestër Edona Podvoricën, gazetare nga Televizioni Publik, RTK. Deputetët e Vetëvendosjes Valon Ramadani dhe Enver Dugolli kanë përdorur Facebook-un për të bërë presion dhe denigrim ndaj gazetarit.¹⁰⁴

99 Po aty.

100 Fokus grup me gazetarë të transmetimeve, OJQ-ve dhe mediave online, realizuar nga Getoarbë Mulliqi më 29.12.2023.

101 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Gjuhë e rrezikshme e ministrit Sveçla ndaj gazetarëve](#)", Prishtinë, 15.07.2023.

102 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Kërcënimi i mëtejshëm ndaj gazetarit Burim Pacolli, Prishtinë, 12.07.2023](#)".

103 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Kosovë: EFJ, AGK, dhe Grupet e Lirisë së Medias Mirëpresin vendimin e Gjykatës për Klan Kosovën](#)", Prishtinë, 3.08.2023.

104 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Presioni publik nga deputetët e Vetëvendosjes ndaj gazetarit të RTK-së](#)", Prishtinë, 2.08.2023.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rasteve
<p>Kërcënimet dhe ngacmimet jofizike</p> <p>Kërcënimet dhe ngacmimet jofizike përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – vëzhgim ose përcjellje. – thirrje telefonike ngacmuese – ngacmimi arbitrar gjyqësor ose administrativ. – deklarata agresive të zyrtarëve publikë. – forma të tjera presioni që mund të rrezikojnë sigurinë e gazetarëve në ndjekjen e punës së tyre. <p>Këto lloj kërcënimesh nuk përfshijnë ngacmimin dhe bullizmin në mjedisin e punës</p>	20 raste	<ul style="list-style-type: none"> – Në vitin 2023, gazetarja Erjola Cacaj nga Portali Nacionale mori kërcënime nga një kompani që kishte fituar një tender në Kosovë. – Ministri i Brendshëm, Xhelal Svecla, përdori gjuhë të rrezikshme dhe të papranueshme ndaj mediave dhe gazetarëve. Ai ka thënë se audio-incizimet e kryetares së Grupit Parlamentar të partisë së tij, Mimoza Kusari Lila, me ish-deputetin e Srpska-s, Simiq, i ka dhënë mediave kosovare presidenti serb, Vuçiq. – Një deputet i partisë në pushtet, Mefail Bajqinovci, ka zbuluar dokumente të brendshme të Administratës Tatimore të Kosovës për të diskredituar gazetarët dhe pronarin e Nacionales, Berat Buzhala. – Një fushatë shpifëse kishte në shënjestër Edona Podvoricën, gazetare nga Televizioni Publik, RTK. Deputetët e Vetëvendosjes Valon Ramadani dhe Enver Dugolli kanë përdorur Facebook-un për të bërë presion dhe denigrim ndaj gazetarit. – Më 12 janar 2023, gazetari Bujar Vitija raportoi për një sërë ofendimesh dhe kërcënimesh të drejtuara ndaj tij pas shkrimeve të tij për gjoja korrupsion në Spitalin Publik të Vushtrrisë. – Më 26 janar 2023, gazetarët në Kosovë mbetën të painformuar për kohën dhe vendndodhjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). – Më 24 shkurt 2023, Agron Beka, anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), gjatë një mbledhjeje të KPK-së ka bërë komente nënçmuese për emisionin "Betimi për Drejtësi". Kjo pasoi transmetimin e një episodi ku shfaqej Beka, i cili ishte i implikuar në sjellje të pahijshme. – Më 2 mars 2023, Hasime Qyqalla, zyrtare nga Komuna e Fushë Kosovës, ka tentuar të frikësojë gazetarin e KALLXO.com, Behar Mustafa, duke kërcënuar se do të iniciojë ndjekje penale. Ky frikësim pasoi një hetim nga KALLXO.com që përfshinte djalin e saj. – Më 3 prill 2023, ish-deputeti i NISMA-s, Zafir Berisha, akuzoi Ermal Pandurin, gazetar i RTV Dukagjinit, si "zëri më besnik i politikës serbe" në lidhje me pasqyrimin e temave të luftës dhe Hagës. – Më 12 maj 2023, gazetarët Kosovë Gjoci nga Euronews Albania dhe Besarta Hoti nga portali Periskopi u përballën me pengesa gjatë mbulimit të ngjarjeve që përfshinin kryeministrin e Kosovës Albin Kurti dhe ministrin e Ekonomisë Artane Rizvanolli. Gjoci ka raportuar se truprojat e Kurtit e kanë shtyrë, i kanë dëmtuar pajisjet dhe e kanë kërcënuar. – Më 28 maj 2023, Dafina Demaku, kryeredaktore e portalit Periskopi, raportoi një fushatë poshtëruese ndaj saj në rrjetet sociale, veçanërisht në TikTok. Ajo u etiketua si "gazetare pro-serbe" dhe "agjente e dyshuar e BIA-s serbe". – Më 31 maj 2023, gazetarët Berat Buzhala, Bekim Kabashi dhe Lavdim Hamidi u vunë në shënjestër të imazheve të manipuluar që qarkullonin në rrjetet sociale. Imazhi i Buzhalës sugjeronte rrejshëm se presidenti serb Aleksandar Vuçiq e vlerësoi atë si një nga gazetarët më të mirë kosovarë. – Më 7 qershor 2023, Artan Abrashi, deputet i partisë në pushtet Vetëvendosje, përdori gjuhë nënçmuese ndaj portalit "Posta Shqiptare" pasi kishte publikuar një artikull mbi sanksionet e mundshme ndaj kryeministrit Albin Kurti. Abrashi ka deklaruar në Facebook, "Portali shqiptar i Sanishic shkruan për sanksione ndaj Kosovës. Emri i saj është shqiptar, por nuk ka lidhje me Shqipërinë". – Më 11 korrik 2023, drejtor për financa në Postën dhe Telekomin e Kosovës, Feim Kelmendi, ka përdorur gjuhë nënçmuese ndaj gazetarëve të "Front Online". – Më 27 korrik 2023, gazetarët që mbulonin Kuvendin e Kosovës u përballën me kufizime gjatë një seance, me një shirit të vendosur mbi zonën e tyre të raportimit, duke ua bllokuar pamjen e Kuvendit dhe deputetëve. – Më 15 gusht 2023, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës shprehu shqetësimin e thellë për një fushatë poshtëruese kundër ueb portalit Nacionale dhe gazetarëve të tij. Në një pankartë në Prizren janë shfaqur fotografitë e gazetarëve Vullnet Krasniqi dhe Berat Buzhala, me mesazhin "Drejtësia për popullin, ndëshkimi për shpifjet. Bojkoto Nacionale". – Më 9 shtator 2023, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës shprehu zhgënjimin për diskriminimin gjinor në pozitën e fundit drejtuese në RTK. Pavarësisht se ishin ranguar më së miri, gazetarët Ilire Zajmi dhe Flora Masurica Durmishi së bashku me juristen Mihrije Beiqi nuk u përzgjedhën në këto pozita.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rasteve
		<ul style="list-style-type: none"> Më 3 tetor 2023, trajneri i futbollit Ismet Munishi përdori komente seksiste drejtuar gazetares sportive Qëndresa Krelani gjatë një programi televiziv. Më 1 dhjetor 2023, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës shprehu shqetësimin për akuzat e gazetares Behare Bajraktari nga Radio Kosova lidhur me kushtet e saj të punës. Bajraktari raportoi se gjërat e saj personale dhe të punës i ishin hequr nga zyra pasi dyshohet se emisioni i saj në radio ishte ndërprerë. Më 28 dhjetor, një video e publikuar nga gazetarja Blerta Dalloshi-Berisha tregonte një anëtare të ekipit të mbrojtjes të kryeministrit Albin Kurti duke e kapur dhe shtyrë atë ndërsa ajo po përpiqej t'i bënte një pyetje kryeministrit

— C.12 KËRCËNIME NDAJ JETËS DHE SIGURISË FIZIKE TË GAZETARËVE

Në vitin 2022, në Kosovë nuk është raportuar asnjë rast i kërcënimit ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve. Megjithatë, komuniteti mediatik është i alarmuar nga numri total prej 11 rasteve të ndodhura në vitin 2023¹⁰⁵. Është shqetësues fakti që kërcënimet online ndaj gazetarëve nuk merren aq seriozisht sa ato të drejtuara ndaj politikanëve. Gazetarët besojnë se qytetarët nuk hezitojnë të bëjnë kërcënime të tilla përmes rrjeteve sociale sepse institucionet e sundimit të ligjit nuk i trajtojnë ato me seriozitetin dhe prioritetin që meritojnë¹⁰⁶.

Më 16 mars, gazetari dhe redaktori i Transmetuesit Publik, Alban Selimi, ka raportuar në Facebook se dikush ka tentuar ta frikësojë duke i djegur garazhin. Gjykata Themelore në Prishtinë ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, me të cilën të dyshuarit A. L. (42 vjeç) i është caktuar masa e paraburgimit prej 30 ditësh, nën dyshimin se ka djegur garazhin e redaktorit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), Alban Selimi¹⁰⁷.

Për më tepër, ekuipazhi i T7 përjetoi një incident shqetësues në Leposaviq, ku u ndoqën nga persona të armatosur duke ekspozuar armët e zjarrit, duke kërkuar që gazetari Unitet Berisha dhe operatori i kamerës Përparim Gashi të ndalonin automjetin e tyre¹⁰⁸. Gjithashtu, ekipi i KIKS-it është përballur me kërcënime në dy raste në vitin 2023. Gazetari Herolind Ademi mori mesazhe të shumta kërcënuese në Facebook nga i njëjti individ në lidhje me një hetim që ai po kryente¹⁰⁹. Më pas, autorët e emisionit hulumtues Ardiana Thaçi Mehmeti dhe Erjona Gjokolli janë kërcënuar nga një person tjetër, duke përfshirë edhe kërcënime ndaj tyre dhe familjeve të tyre¹¹⁰. Burim Pacolli i Nacionale mori kërcënime të vazhdueshme në profilin e tij në Instagram, nga dikush që postonte publikisht mesazhe kërcënuese dhe kërkonte adresën e shtëpisë së tij, duke e etiketuar atë në postime publike¹¹¹. Për më tepër, gazetarët Fatos Hetemi dhe Irfan

105 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Baza e të dhënave të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. Kosovë, 2023.

106 Po aty.

107 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Kërcënimi ndaj redaktorit Alban Selimi](#)", Prishtinë, 16.03.2023.

108 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Ekipi T7 kërcënohet me armë zjarri në Leposaviq](#)", Prishtinë, 8.02.2023.

109 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Kërcënohet me vdekje gazetari Herolind Ademi](#)", Prishtinë, 8.11.2023.

110 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Kërcënim ndaj gazetarëve Ardiana Thaçi Mehmeti dhe Erjona Gjokolli](#)", Prishtinë, 30.11.2023.

111 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Kërcënohet gazetari Burim Pacolli](#)", Prishtinë, 14.12.2023.

Maliqi nga media lokale Plus TV janë kërcënuar me vdekje për shkak të një shkrimi për dy xhami në komunën e Vitisë¹¹².

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rasteve
<p>Kërcënime ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve</p> <p>Kjo kategori mund të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – referenca për vrasjen e gazetarëve, miqve të gazetarëve, familjes ose burimeve. – referenca për dëmtimin fizik ndaj gazetarëve, miqve të gazetarëve, familjes ose burimeve. <p>Këto kërcënime mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – bëhen drejtpërdrejt ose nëpërmjet palëve të treta. – përçohen nëpërmjet komunikimeve elektronike ose ballë për ballë. – mund të jenë të nënkuptuara dhe të qarta. 	11 raste	<ul style="list-style-type: none"> – Tentativa për zjarrvënie në garazhin/shtëpinë e Alban Selimit. – Ekuipazhi i T7 u ndoqën nga persona të armatosur në Leposaviq duke ekspozuar armët e zjarrit, duke kërkuar që gazetari Unitet Berisha dhe operatori i kamerës Përparim Gashi të ndalonin automjetin e tyre. – Ekipi i KIKS-it është përballur me kërcënime në dy raste në vitin 2023. Gazetari Herolind Ademi mori mesazhe të shumta kërcënuese në Facebook nga i njëjti individ në lidhje me një hetim që ai po kryente. – Ardiana Thaçi Mehmeti dhe Erjona Gjickolli janë kërcënuar nga një person tjetër, duke përfshirë edhe kërcënime ndaj tyre dhe familjeve të tyre. – Burim Pacolli i Nacionale mori kërcënime të vazhdueshme në profilin e tij në Instagram, nga dikush që postonte publikisht mesazhe kërcënuese dhe kërkonte adresën e shtëpisë së tij, duke e etiketuar atë në postime publike. – Gazetarët Fatos Hetemi dhe Irfan Maliqi nga media lokale Plus TV janë kërcënuar me vdekje për shkak të një shkrimi për dy xhami në komunën e Vitisë. – Më 27 prill 2023, Edmonda Avdija, gazetare në Televizionin Syri në Gjakovë, raportoi se kishte marrë kërcënime nga një individ i identifikuar si B.A. ndërsa ishte në Meje. – Më 2 qershor 2023, ekipi i RTV 21, përfshirë gazetarin Venhar Isufi dhe operatorin e kamerës Olti Pacolli, është ndjekur dhe kërcënuar nga persona të maskuar në Leposaviq. Ata u penguan gjatë përpjekjes për të filmuar negociatat mes ish-kryetarit Zoran Todiç dhe zyrtarëve të KFOR-it. – Më 29 korrik 2023, Alberta Hashani, gazetare dhe Dituron Aliu, operator i kamerës të "Betimi për Drejtësi", morën kërcënime me vdekje teksa po punonin për një hulumtim që do të publikohej në shtator. Ata janë kërcënuar nga një shitës i mallrave ilegale, i cili i ka dërguar një mesazh Aliut duke lënë të kuptohet se "i ka borxh ca gjak". – Më 20 tetor 2023, gazetari Agim Ademi ka marrë një kërcënim nga një individ i identifikuar si S.B. gjatë inaugurimit të çerdhes publike në Godanc të Shtimes. S.B. e paralajmëroi atë të mos shkruante për kryetarin e komunës apo zyrtarët lokalë. – Më 14 dhjetor 2023, gazetari Fatlum Berisha raportoi se kishte marrë kërcënime me vdekje në TikTok, duke përfshirë një koment që thoshte: "Duhet të të kisha dhënë 31 plumba".

— C.13 SULMET AKTUALE

Gjatë vitit 2023, në Kosovë kanë ndodhur 20 raste të sulmeve, ku disa kanë përfshirë më shumë se një ekip mediatik në të njëjtën kohë. Shumica e këtyre sulmeve ndodhën në pjesën veriore të Kosovës¹¹³.

Krahasuar me vitin 2022, numri i rasteve u rrit, ku shumica e këtyre sulmeve u përqendruan në 29 dhe 30 maj, si dhe në 16 qershor. Njëmbëdhjetë nga 20 raste kanë ndodhur në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe komunën e Mitrovicës së Veriut. Një nga rastet më të rënda ishte operatori i kamerës Bardh Bekteshi, i ndjekur nga Pleurat Salihu, i cili pësoi një thyerje të krahut¹¹⁴. Dorentina Thaqi është goditur me gur në kokë, krahas gazetarëve dhe kamerave të tjera para komunës së Leposaviqit¹¹⁵.

112 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Kërcënime me vdekje ndaj gazetarëve të Plus TV Fatos Hetemi dhe Irfan Maliqi](#)", Viti, 11.11.2023.

113 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Baza e të dhënave të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. Kosovë, 2023.

114 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Media u sulmuan në Leposaviq: Kameramani i RTK-së, Bardh Bekteshi, ka pësuar lëndime të rënda në kokë dhe në trup](#)." dhe "[Sulm fizik ndaj gazetarit Pleurat Salihu](#)", Leposaviq, 16.06.2023.

115 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Gazetarja e RTV Dukagjinit Dorentina Thaqi sulmohet me gur në kokë](#)", 16.06.2023.

Një nga rastet më të rëndësishme ishte gazetari Valon Sylja, i cili u sulmua nga një grup prej tre individësh pas paraqitjes së tij në një debat televiziv, në të cilin ai merr pjesë rregullisht¹¹⁶. Vullnet Krasniqi dhe operatori i kamerës Arbër Latifi u sulmuan fizikisht nga një grup protestuesish më 11 gusht në Prizren¹¹⁷. Përveç kësaj, i njëjti operator i kamerës nga Nacionale ishte sulmuar tri javë më parë në Gjakovë. Gjatë një proteste të organizuar nga Partia Politike e PSD-së, një grup gazetarësh janë sulmuar nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të cilët kanë përdorur gaz lotsjellës kundër tyre¹¹⁸. Inspektorati Policor i Kosovës ka nisur menjëherë procedurat lidhur me këtë incident.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rasteve
Sulmet ndaj gazetarëve Llojet e sulmeve aktuale mund të përfshijnë dëmtim aktual fizik ose mendor, rrëmbim, pushtim të shtëpisë/zyrës, pajisje të sekuestruara, ndalim arbitrar, tentativa të dështuara për atentat, etj.	20 raste	<ul style="list-style-type: none"> – Një nga rastet më të rënda ishte operatori i kamerës Bardh Bekteshi, i ndjekur nga Pleurat Salihu, i cili pësoi një thyerje të krahut. – Dorentina Thaqi është goditur me gur në kokë, krahas gazetarëve dhe kamerave të tjera para komunës së Leposaviqit. – Gazetari Valon Sylja u sulmua nga një grup prej tre individësh pas paraqitjes së tij në një debat televiziv, në të cilin ai merr pjesë rregullisht. – Vullnet Krasniqi dhe operatori i kamerës Arbër Latifi u sulmuan fizikisht nga një grup protestuesish më 11 gusht në Prizren. – Përveç kësaj, i njëjti operator i kamerës nga Nacionale ishte sulmuar tri javë më parë në Gjakovë. – Gjatë një proteste të organizuar nga Partia Politike e PSD-së, një grup gazetarësh janë sulmuar nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të cilët kanë përdorur gaz lotsjellës kundër tyre. – Në maj të vitit 2023, gazetarë të mediave të ndryshme u sulmuan nga protestuesit serbë në Komunën e Leposaviqit. Derisa ishin në transmetim të drejtpërdrejtë, disa gra mund të shiheshin duke u përpjekur t'i pengojnë gazetarët e mediave KOHA, RTV Dukagjini dhe mediave të tjera që të raportojnë në këtë komunë. – Në maj të vitit 2023, gazetarët e Tëvë1 kanë njoftuar Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës se disa persona i kanë thyer kamerat derisa po raportonin në Komunën e Leposaviqit. – Në maj të vitit 2023 gazetarëve të Kanal10 iu dëmtuan automjetet gjatë raportimit në pjesën veriore të vendit, veçanërisht në Zveçan. – Gazetarja Lirie Dibrani dhe kameramani Berat Bahtiri nga RTV21 janë sulmuar fizikisht nga protestuesit serbë gjatë raportimit në sheshin Car Lazar. – Më 31 maj, shumë gazetarë të Komunës së Zveçanit u sulmuan nga protestuesit vendas teksa po tentonin të filmonin momentin e sulmit ndaj një veture të Policisë së Kosovës. Në mesin e tyre edhe Burim Zariqi nga RTV21 është sulmuar fizikisht nga protestuesit. – Në muajin qershor, shumë gazetarë janë sulmuar në Komunën e Leposaviqit gjatë raportimit. Mes të plagosurve ishte edhe operatori i kamerës Albin Rrahmani, i cili kishte lëndime në këmbë. – Më 16 qershor, gazetarja Laura Kerolli dhe operatori i kamerës Ardijan Shala nga portali IndeksOnline janë sulmuar fizikisht në Leposaviq. – Më 16 qershor 2023, gazetarja Qendresa Sinani nga Klan Kosova u plagos në këmbën e djathtë nga protestues të maskuar gjatë raportimit në Leposaviq. – Më 16 gusht 2023, kameramani i Lajmi.net u sulmua teksa po filmonte shkyçjen e borxhlinjve në Shtime nga KRU Prishtina. – Më 17 shtator 2023, gazetarja Ulpiana Emra nga ArtMotion u sulmua nga fansat teksa po mbulonte ndeshjen finale të basketbollit të Superkupës ndërmjet Trepçës dhe Pejës në Suharekë. – Më 10 nëntor 2023, një ekip i portalit "Insajderi" u sulmua në Vushtrri nga imami vendas Halili. – Më 29 nëntor 2023, gjatë një proteste të organizuar nga Partia Socialdemokrate (PSD) në Prishtinë, kameramani Bujar Sylejmani nga Zëri i Amerikës është shtyrë me forcë teksa punonte

116 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "Sulm fizik ndaj gazetarit Valon Sylja", Prishtinë, 11.04.2023.

117 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "Sulm fizik ndaj gazetarit Vullnet Krasniqi dhe kameramanit Arbër Latifi", Prizren, 11.08.2023.

118 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Baza e të dhënave të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. Kosovë, 2023.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rasteve
		<ul style="list-style-type: none"> Më 16 dhjetor 2023, gazetarja Rinë Haziri nga Lajmi.net ishte penguar dhe sulmuar gjatë raportimit nga Brezovica. Një person i kërkoi asaj të ndalonte regjistrimin, më pas i mori me forcë telefonin duke e kërcënuar

— C.14 KËRCËNIME DHE SULME NDAJ MEDIAVE DHE SHOQATAVE TË GAZETARËVE

Gjatë vitit 2023, janë raportuar 23 raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj mediave, ku 16 kanë ndodhur në veri të Kosovës, veçanërisht gjatë majit dhe qershorit¹¹⁹.

Situata është përkeqësuar me një rritje prej 14 rastesh krahasuar me vitin 2022. Gjithashtu, ashpërsia e rasteve është përshkallëzuar, ku këto incidente kanë ndodhur kryesisht gjatë raportimeve të gazetarëve nga tensionet në veri. Gazetarët u përballën me kërcënime të ndryshme duke përfshirë dëmtimin e pronës personale, dëmtimin e pronës intelektuale dhe forma të tjera agresioni. Konkretisht, një automjet i TëVë1-s fillimisht është dëmtuar dhe më pas i është vënë flaka¹²⁰. Akte të ngjashme vandalizmi janë parë edhe në mjete të tjera mediatike, ku janë dëmtuar edhe shumë kamera dhe telefona.

Një nga incidentet më të rëndësishme të viteve të fundit lidhur me mediat është rasti i Televizionit Klan Kosova. Në mesin e qershorit, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë i pezulloi licencën e biznesit kësaj medie private, një vendim i paprecedentë dhe pa bazë ligjore dhe njoftim paraprak. Edhe pse Gjykata Komerciale e hodhi poshtë këtë vendim në fund të korrikut, ai konsiderohet gjerësisht nga aktorët përkatës, si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar, si një sulm shumë i rrezikshëm ndaj lirisë së mediave në Kosovë.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rasteve
Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve Sulmet aktuale mbi pronën e organeve dhe organizatave të mediave, personelit të tyre, pajisjet e sekuestruara, deklaratat agresive nga zyrtarët publikë etj. Gjithashtu, kërcënimet dhe sulmet mund të përfshijnë disa nga kategoritë e renditura më sipër.	23 raste	<ul style="list-style-type: none"> Një automjet i TëVë1 fillimisht është dëmtuar dhe më pas i është vënë flaka. Në mesin e qershorit, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë i pezulloi licencën e biznesit kësaj medie private, një vendim i paprecedentë dhe pa bazë ligjore dhe njoftim paraprak. Më 13 mars 2023, Vaxhid Rexhepaj, shef i kabinetit të kryetarit të Komunës së Kamenicës, Kadri Rrahimaj, përdori gjuhë të papërshtatshme ndaj gazetarit të Televizionit 7, Çlirimtar Morina. I pyetur për një fotomontazh viral të ekspozuar në zyrën e Rrahimaj, Rexhepaj në vend që të përgjigjej sulmoi mediat, duke thënë: "Ne do t'ua dërgojmë pikturën pronarëve tuaj, siç është Aleksandar Vuçiq". Më 30 mars 2023, Blerim Vela, shef i kabinetit në zyrën e Presidentit Osmani, sulmoi mediat kosovare pas raportimeve për një vendim të mundshëm të Gjykatës Kushtetuese që mund të shpallte të pavlefshme zgjedhjen e Osmanit. Në një seri postimesh në Twitter, Vela e përshkroi raportimin e mediave si pjesë të një "luftë speciale" të orkestruar nga Beogradi dhe të kryer nga "kriminelët nga veriu i Kosovës". Më 25 maj 2023, Sami Kurteshi, anëtar i partisë Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kishte sulmuar me dhunë mediat pas emërimit të Luljeta Aliut në Komisionin e Pavarur për Media. Ai akuzoi gazetarët se janë pjesë e "krimit të organizuar politiko-ekonomik" të lidhur me "PLANET", duke thënë se "AGK-ja është pjesë e pandashme e makinerive të tyre të pista të krimit".

119 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Baza e të dhënave të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. Kosovë, 2023.

120 Asociacioni i Gazetarëve Kosovës. "[Vënia e zjarrit në automjetin e ekipit T7](#)", Zubin Potok, 29.05.2023.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rasteve
		<ul style="list-style-type: none"> - Më 16 gusht 2023, disa ekipe mediatike janë kërcënuar dhe sulmuar gjatë mbulimit të një ngjarjeje të KRU Prishtinës në Shtime. Një kameraman nga Lajmi.net është sulmuar fizikisht, ndërsa gazetarët e tjerë derisa kanë filmuar një burrë duke kritikuar mediat kanë marrë kërcënime. - Më 5 shtator 2023, stafi në RTV Besa në Prizren raportoi se ishte kërcënuar nga Lulzim Kabashi, ish-kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në këtë komunë. Sipas një emaili dërguar Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Kabashi ka "bastisur" zyrat e RTV Besës, duke kërcënuar jetën e stafit si reagim ndaj mbulimit mediatik të një ish-kandidati të AAK-së, i cili u arrestua me akuzën e posedimit të drogës. - Më 26 maj 2023, ekipi i KOHA u sulmua me gurë nga persona të maskuar gjatë raportimit në Zveçan. Fatmirësisht nga ngjarja nuk ka persona të lënduar. - Më 29 maj 2023, veturat e RTV Dukagjinit dhe KALLXO janë vandalizuar nga protestuesit në Leposaviq. Videot treguan makinat e dëmtuara me slogane të ndryshme në gjuhën serbe. - Më 29 maj 2023, një automjet i Top Channel u vandalizua nga protestuesit në Zveçan. - Më 29 maj 2023, dy persona të maskuar kanë tentuar të sulmojnë ekipin e Periskopit në Zveçan. Në një fotografi të dërguar Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës shihet një koleg me këmishë të grisur nga incidenti, por fatmirësisht nuk ka të lënduar. - Më 29 maj 2023, redaksia e Gazetës Papyrus raportoi se tre persona të maskuar ua rrëzuan kamerën derisa ekipi i mediave po filmonte automjetet e KFOR-it në Zveçan. - Më 29 maj 2023, një automjet i ekipit të TV Syri është qëlluar në Zveçan teksa po kthehej nga raportimi. Ekipi dëgjoji një zhurmë të çuditshme dhe më vonë gjeti një vrimë plumbi. - Më 30 maj 2023, automjeti i ekipit KOHA, i cili raportonte nga Zveçani, ishte gjetur tërësisht i vandalizuar. Fotot dhe videot tregonin xhamat e thyer, simbolet nacionaliste në automjet dhe pasqyrat anësore të hequra. - Më 30 maj 2023, automjeti i ekipit të ATV-së u sulmua nga protestuesit serbë, me foto që tregonin se gomat ishin shfryrë qëllimisht për të penguar raportimin. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës shprehu shqetësimin për shënjestrimin e gazetarëve nga protestuesit lokalë serbë. - Më 30 maj 2023, automjetet e A2 CNN dhe Panorama janë vandalizuar me tulla dhe gurë teksa ekipet e tyre ndodheshin brenda Leposaviqit. Fatmirësisht nuk ka pasur të lënduar. - Më 30 maj 2023, automjeti i portalit online Periskopi është gjetur i dëmtuar në Zveçan, me vrime të plumbave. - Më 30 maj 2023, një mjet shpërthyes u hodh në një taksì që transportonte ekipin e Radios Evropa e Lirë në Zubin Potok nga një grup protestuesish vendas serbë. - Më 31 maj 2023, ekipit të RTV Dukagjinit i është dëmtuar vetura gjatë raportimit në Zveçan. Fatmirësisht nuk ka pasur të lënduar, por kjo shënnon automjetin e dytë të kësaj medie së vandalizuar nga protestuesit vendas. - Më 31 maj 2023, vetura e ekipit të Syri.net u vandalizua në Leposaviq kur protestuesit serbë i shpuan gomat. - Më 13 qershor 2023, ekipi i ATV-së, duke përfshirë gazetarin Fatlum Jashari, kameramani Blend Thaçi dhe shoferin Enis Sherifi, u sulmuan me gurë në Zveçan teksa mbulonin zhvillimet lokale. - Më 15 qershor 2023, vetura e ekipit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), ku ishin gazetarja Arbresha Berisha, kameramanët Ilir Uka dhe Bardh Bekteshi dhe inxhinieri Mentor Vinarci, u sulmua në Zveçan. Gjatë raportimit të drejtpërdrejtë, Berisha raportoi se disa persona kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të mjetit dhe i kanë shpuar gomat. Fatmirësisht nuk ka pasur të lënduar. - Më 18 shtator 2023, zëvendëskryeministri i Kosovës Besnik Bislimi sulmoi mediat gjatë një konference për shtyp, duke pretenduar se ato "financohen nga Serbia".



Përfundime dhe rekomandime

PËRFUNDIMI

MASAT MBROJTËSE LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

Përkundër garancive kushtetuese për lirinë e fjalës, qasjen në informacion dhe mbrojtjen e burimeve, të cilat janë vetëm disa nga garancitë kushtetuese, këto garanci gjithsesi nuk zbatohen në praktikë. Ekzistenca e tyre në letër nuk mjafton për t'i lejuar mediat në Kosovë të bëjnë punën e tyre lirisht. Siç u përmend më lart, neni 41 i Kushtetutës garanton qasjen në dokumente publike; megjithatë, gazetarët në Kosovë përballen me shumë sfida në marrjen e informacioneve të rëndësishme nga dokumentet publike, pasi institucionet hezitojnë t'u përgjigjen kërkesave të gazetarëve për marrjen e informacionit. Për më tepër, një nga shqetësimet kryesore është joefikasiteti dhe politizimi i KPM-së, i cili është përballur me periudha të zgjatura të mosfunksionimit për shkak të emërimeve të vonuara dhe çështjeve të transparencës në procesin e tij zgjedhor. Ky mosfunksionalitet minon rolin e tij në rregullimin e mediave dhe sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet e mediave. Për më tepër, një numër gjithnjë e më i madh i gazetarëve janë përballur me paditë SLAPP të ngritura nga biznese të ndryshme të fuqishme, individë dhe politikanë, me qëllim të frikësimit dhe heshtjes së gazetarëve.

POZICIONI I GAZETARËVE NË REDAKSINË E LAJMEVE

Pagat e ulëta, mungesa e kontratave, mungesa e mbulimit të sigurimeve shoqërore dhe presioni që vije nga pronarët e mediave janë vetëm disa nga problemet urgjente me të cilat përballen gazetarët në redaksi. Rreth 25% e gazetarëve kanë kontrata me afat të caktuar dhe shumica e gazetarëve punojnë me kontrata të përkohshme që nuk ofrojnë asnjë siguri pune dhe asnjë mbulim nga sigurimet shoqërore. Më së shumti janë gazetarët e pavarur ata që preken nga këto probleme për shkak të mungesës së pensioneve, duke i detyruar të merren me aktivitete

të tjera jogazetare për të siguruar jetesën. Në sektorin privat, veçanërisht në profesionin e gazetarisë, mungesa e sindikatave i lë gazetarët pa mekanizëm të duhur për të adresuar këto çështje. Një shqetësim tjetër është pavarësia editoriale ku gazetarët u nënshtrohen presioneve të shumta nga pronarët dhe sponsorët e mediave, veçanërisht në mediat private ku tërheqja e sponsorizimeve rezulton të jetë burim konflikti interesi. Këto sfida minojnë stabilitetin dhe integritetin e gazetarisë në Kosovë.

SIGURIA E GAZETARËVE

Sa i përket sigurisë së gazetarëve, situata konsiderohet mjaft shqetësuese. Numri i sulmeve ndaj gazetarëve ka qenë më i larti në historinë më të re të vendit. Megjithatë, këto sulme ndaj gazetarëve janë vetëm një nga disa sfida dhe çështje urgjente me të cilat ballafaqohen gazetarët në Kosovë kur bëhet fjalë për sigurinë. Një nga çështjet kryesore në lidhje me sigurinë e gazetarëve është sistemi i pamjaftueshëm për raportimin e kërcënimeve dhe sulmeve. Dy vendet kryesore ku gazetarët raportojnë rastet e tyre janë Policia e Kosovës (PK) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). Megjithatë, ka mospërputhje në bazat e të dhënave të tyre, gjë që çon në joefikasitet në gjurmimin dhe trajtimin e këtyre rasteve. Për më tepër, mungesa e një procedure sistematike të vlerësimit të rrezikut dhe e njësive të dedikuara për hetimin e sulmeve e bën të pamundur garantimin e sigurisë së gazetarëve dhe aftësimin e tyre për të kryer punën e tyre në një mjedis të sigurt. Ndonëse në aspektin ligjor, duke përfshirë këtu kornizën ligjore të Kosovës dhe marrëveshjet ndërkombëtare, siç është Konventa e Stambollit, gazetarët mbrohen, në shumicën e rasteve kësaj mbrojtjeje i mungon konsistenca, veçanërisht kur kemi të bëjmë me raste të ngacmimeve online dhe kërcënimeve jofizike.

PËRFUNDIM I PËRGJITHSHËM

Në vitin 2023, peizazhi mediatik në Kosovë është përballur me sfida të rëndësishme, duke përfshirë qasjen e pamjaftueshme në informacion dhe rritjen e sulmeve verbale dhe fizike. Pavarësisht nga garancitë ligjore për lirinë e shtypit dhe qasjen në informacion, zbatimi i tyre në praktikë do të përballej me një sërë pengesash. Edhe pse Kushtetuta e Kosovës është në përputhje me konventat ndërkombëtare, zbatimi i saj praktik mbetet i pamjaftueshëm sa i përket qasjes së gazetarëve në dokumente publike dhe Komisioni i Pavarur për Media (KPM) joefektiv dhe i politizuar. Paditë SLAPP gjithashtu vazhdojnë të përbëjnë një kërcënim për mbylljen e gazetarëve dhe raportimin kritik. Nuk janë përmirësuar as kushtet e punës së gazetarëve, të karakterizuara nga paga të vogla, kontrata të pasigurta dhe presion i vazhdueshëm editorial nga pronarët e mediave që cenojnë pavarësinë e tyre. Shqetësimet për sigurinë janë gjithashtu alarmante me theksin në sulmet kundër gazetarëve dhe mungesën e mekanizmave të duhur për raportimin dhe hetimin e këtyre kërcënimeve që minojnë mjedisin e përgjithshëm për gazetarinë e lirë dhe të pavarur në Kosovë.

REKOMANDIME

MASAT MBROJTËSE LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

- Rritja e paanshmërisë dhe qëndrueshmërisë së TSHP-së – RTK-së. Sigurimi i qëndrueshmërisë ligjore dhe financiare të TSHP-së, RTK-së për të mbajtur llogaridhënien e saj në përputhje me statusin e saj. Identifikimi i mekanizmave të duhur të financimit për të mbështetur operacionet e saj në mënyrë efektive.
- Sigurimi që emërimi dhe caktimi i anëtarëve të bordit të TSHP-së të jetë jopolitik për të zbutur rrezikun e ndikimit politik. Praktika aktuale e mbështetjes vetëm në emërimet nga Kuvendi i Kosovës mund të rrezikojë pavarësinë e TSHP-së.
- Forcimi i Kompetencave të Organeve Vetërregulluese, si dhe fuqizimi i pozitës së tij brenda komunitetit.
- Rivlerësimi i procesit të emërimit të bordit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) për të minimizuar subjektivitetin dhe ndërhyrjet politike. Zbatimi i rregulloreve më të rrepta në lidhje me përkatësitë politike të anëtarëve të bordit.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të vendosë procedura për trajtimin e padive për shpifje kundër gazetarëve për të siguruar trajtim të drejtë dhe të paanshëm të rasteve të tilla.
- Të njihen dhe të luftohen paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) për të mbrojtur lirinë e shprehjes dhe për të parandaluar keqpërdorimin e veprimeve ligjore për të shtypur aktivitetet gazetareske.

POZICIONI I GAZETARËVE NË REDAKSINË E LAJMEVE

- Mediat duhet të kenë prioritet përdorimin e Kodit të Etikës si gur themeli i sjelljes gazetareske për të rritur cilësinë e raportimit dhe për të promovuar profesionalizmin në mesin e gazetarëve.
- Rritja e respektimit të standardeve profesionale duke zbatuar Kodet e Sjelljes. Bashkëpunimi me organizata si AGK, EFJ, UN Women, NDI, OSBE dhe KiE për të zhvilluar seanca trajnimit për gazetarët mbi praktikën më të mira në raportimin e lajmeve.
- Të inkurajohen organizatat mediatike që të krijojnë kodet e tyre të sjelljes ose të miratojnë udhëzime ekzistuese vetërregulluese për të mbështetur gazetarinë etike.
- Subjektet e mediave duhet të investojnë në rritjen e aftësive të tyre për verifikimin e fakteve dhe për të luftuar dezinformimin. Sigurimi i pavarësisë editoriale duke ndjekur një hierarki të qartë mediatike ku menaxherët mbështesin raportimin e paanshëm.

- T'i jepet përparësi sigurisë fizike, ekonomike dhe psikologjike të gazetarëve duke zbatuar mekanizma sigurie brenda strukturave të pronësisë së mediave. Krijimi i një sindikate gjithëpërfshirëse për gazetarët që të avokojnë për mirëqenien e tyre afatgjatë.
- Zhvillimi dhe zbatimi i rregulloreve që rregullojnë procedurat e punësimit për gazetarët përmes Inspektoratit të Punës. Përmirësimi i efikasitetit në trajtimin e shkeljeve të të drejtave të punës dhe forcimi i rolit të sindikatave për të promovuar kushte më të mira pune si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat të mediave.
- AGK-ja duhet të mbështesë në mënyrë aktive gazetarët në avokimin për përmirësimin e kushteve të punës, të marrë pjesë në diskutimet parlamentare mbi legjislacionin për mediat dhe të mbrojë të drejtat e gazetarëve kur ata janë në rrezik për t'u kompromentuar.

SIGURIA E GAZETARËVE


- Qeveria e Kosovës duhet t'i japë prioritet krijimit të një mjedisi të sigurt për gazetarët duke iu mundësuar qasje, duke adoptuar një qasje miqësore, duke ruajtur transparencën dhe, më e rëndësishmja, duke ofruar mbrojtje në përmbushjen e detyrës së tyre.
- Rastet që përfshijnë kërcënime dhe sulme kundër gazetarëve duhet të kenë prioritet nga gjykatat në Kosovë. Duhet të zhvillohen politika të veçanta që synojnë mbrojtjen e gazetarëve përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sundimit të ligjit, organeve të drejtësisë dhe AGK-së.
- Gjykatat duhet të krijojnë një kornizë specifike për mbledhjen e të dhënave për rastet që lidhen me sigurinë e gazetarëve për të kuptuar dhe trajtuar më mirë këto çështje.
- Njësi të veçanta brenda institucioneve të sundimit të ligjit dhe gjyqësorit duhet t'i përkushtohen garantimit të sigurisë së gazetarëve. Këto njësi do të fokusohen në zbatimin e masave për mbrojtjen e gazetarëve dhe parandalimin e dëmtimit ndaj tyre.

IV Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Kosovë – 2023

Ky seksion i raportit paraqet grafikisht Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve në vitin 2023, krahasuar me vitin e kaluar 2022. Për secilin nga katër dimensionet dhe për të 19 treguesit, është paraqitur një shpjegim i shkurtër i ndryshimeve kryesore që kanë ndodhur në vitin 2023.

Një shpjegim më i gjerë i të dhënave dhe ndryshimeve që kanë ndodhur për secilin tregues individual të Indeksit mund të lexohet në pjesën narrative të raportit:

Treguesi në Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve	Raport narrativ
I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	
Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimin e tyre nuk krijojnë efekt ftohës për gazetarët dhe mediat	A.6
Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është i garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet	A.8
Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe u mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt	A.7
Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të krijojnë, anëtarësohen dhe marrin pjesë në shoqatat e tyre	A.9
Pozicioni i punës i gazetarëve është i qëndrueshëm dhe i mbrojtur në vendin e punës	B.1
II. Parandalimi i dhur	
Gazetarët dhe akterët e mediave kanë qasje në masat mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive	C.1
Gazetarët dhe akterët e tjerë të mediave kanë qasje në mekanizma të posaçëm mbrojtjeje ose sigurie	C.2
Gazetarët femra kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetës	C.3
Praktika e dënimit të rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave	C.4
Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj çështjeve të mbrojtjes së gazetarëve	C.5
III. Procesi i rregullt	
Njësitë/zyrtarët e specializuar janë të pajisur me ekspertizë për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve	C.6
Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen me efikasitet	C.7
Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efikase nga forma të ndryshme të ngacmimeve në internet	C.8
Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente	C.9
Sistemet e grumbullimit të statistikave cilësore të krijuara nga autoritetet shtetërore për të frenuar mosndëshkimin	C.10
IV. Siguria aktuale	
Kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike	C.11
Kërcënime ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve	C.12
Sulmet aktuale	C.13
Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve	C.14




Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Kosovë – 2023

	2022	2023	Zhvillimet e reja kryesore në çdo dimension
Mjedisi Ligjor dhe Organizativ	3.67	3.63	↓ Ligjet për shpifje në Kosovë i japin përparësi lirisë së shprehjes në përputhje me standardet evropiane, por paditë SLAPP kanë qenë mjaft të zakonshme kundër gazetarëve dhe aktivistëve. Megjithatë, edhe pse rastet përkatëse kalojnë në mënyrë të drejtë nëpër gjykata, shqetësimet për efikasitetin e tyre mbeten, dhe paditë SLAPP si të tilla mbeten ligjërish të panjohura, duke i lënë gazetarët pa mbrojtje. Megjithatë, mbrojtja e burimit është e garantuar me ligjet e Kosovës dhe nuk është raportuar asnjë shkelje në vitin 2023. Gazetarët e ushtrojnë lirisht profesionin e tyre dhe nuk kërkohen licenca shtetërore; megjithatë, shumë gazetarë punojnë me kontrata të përkohshme dhe, veçanërisht në mediat e vogla, ata përballen me lloje të tjera vështirësish si mungesa e sigurimeve shoqërore dhe problemet me pagat. Mediat private përfituan nga një rritje prej 28% në pagat e punonjësve të tyre, por atyre u mungonin ende sindikatat për të adresuar shqetësimet e gazetarëve.
Parandalimi i duhur	3.38	3.36	↓ Edhe pse ka mbrojtje ligjore në Kodin Penal kundër kërcënimeve të rënda ndaj sigurisë së gazetarëve në Kosovë, mungesa e procedurave sistematike të vlerësimit të rrezikut e bën këtë mbrojtje në mënyrë të konsiderueshme të mangët. Sa i përket dhunës me bazë gjinore, edhe pse shteti ofron disa mekanizma për ta trajtuar atë, zyrat e mbrojtjes së viktimave dhe shërbimet e ndihmës juridike falas nuk janë mbështetje e veçantë në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike për gratë gazetare. Raportet tregojnë se edhe pse institucionet përgjigjen ndaj rasteve të grave gazetare, në krahasim me gazetarët meshkuj, ato marrin lloje të veçanta të kërcënimeve personale. Në vitin 2023, dënimi publik kundër sulmeve ndaj gazetarëve ka qenë jokonsistent, dhe njohja e qeverisë ka mbetur kryesisht në sulmet fizike, ndërsa ato verbale që kontribuojnë në klimën në rritje të ngacmimit janë injoruar. Megjithatë, bashkëpunimi me Policinë e Kosovës mbetet i fortë, duke reflektuar përkushtimin për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve, duke siguruar që ata të mund ta kryejnë punën e tyre pa asnjë pengesë.
Procesi i rregullt	3.30	3.27	↓ Në vitin 2023, Kosova u përball me sfida të mëdha në mbrojtjen e gazetarëve dhe lirisë së mediave, me disa përmirësime të vogla në këtë drejtim. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka krijuar një bazë të dhënash të padive dhe rasteve që përfshijnë gazetarë; në të njëjtën kohë mungojnë njësitet e specializuara hetimore për veprat penale kundër gazetarëve. Janë emëruar koordinatorë brenda policisë dhe gjyqësorit, megjithatë profesionalizmi dhe njohuritë e ekspertëve në trajtimin e masave mbrojtëse ligjore mbeten të dobëta. Hetimet për sulmet fizike ndaj gazetarëve mbeten të ngadalta dhe joefektive, ndërkohë që transparencën në procedurat gjyqësore ishte gjithashtu e kufizuar. Në këtë vit gjithashtu ndodhën tetë raste të ngacmimeve në internet së bashku me përpjekjet shqetësuese të qeverisë për të rregulluar përmbajtjen e mediave, veçanërisht Klan Kosova.

	2022	2023		Zhvillimet e reja kryesore në çdo dimension
Siguria aktuale	2.66	2.34	↓	Në vitin 2023 ka pasur një përkeqësim të jashtëzakonshëm të kërcënimeve jofizike dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve në Kosovë. Ndërsa u rrit në 20 raste, u rrit edhe ashpërsia e tyre, pasi zyrtarët dhe qytetarët përdornin gjuhë shumë të rrezikshme në platformat e mediave sociale. Për më tepër, këtë vit ka pasur një rritje shqetësuese të nivelit të kërcënimeve ndaj jetës dhe integritetit fizik të gazetarëve: në fakt janë raportuar 11 raste, duke përfshirë tentativën për zjarrvënie në pronën e gazetarit Alban Selimi. Sulmet fizike gjithashtu u rritën -20 raste u regjistruan, shumica prej tyre në veri të Kosovës, veçanërisht gjatë majit dhe qershorit, kur ekipet mediatike ishin shënjestruar vazhdimisht. Sulmet përfshinin vandalizimin e automjeteve të mediave dhe dëmtimin e pajisjeve; për shembull automjeti i TëVë1 është djegur.
Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve	3.05	2.87	↓	

Mjedisi Ligjor dhe Organizativ



TREGUESI 1.1

— DISPOZITAT LIGJORE NË LIDHJE ME SHPIFJEN DHE ZBATIMI I TYRE NUK PRODHOJNË EFEKTE DEKURAJUESE PËR GAZETARËT DHE MEDIAT

Rezultati për 2022: 3.50 / Rezultati për 2023: 3.50

Në treguesin 1.1, rezultatet mbeten të njëjta si në vitin 2023 dhe reflektojnë se Kosova ka bërë shumë pak ose aspak për të përmirësuar situatën dhe infrastrukturën ligjore për të pasur ndonjë efekt në peizazhin mediatik ose për të përmirësuar kushtet e punës së gazetarëve. Në Kosovë, Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, i miratuar në vitin 2008, thekson prioritizimin e lirisë së shprehjes, në përputhje me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Interpretimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kanë përparësi ndaj ligjit të brendshëm në rastet e konfliktit ligjor. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) monitoron mijëra seanca gjyqësore çdo vit, përfshirë rastet e shpifjes. Në vitin 2023, IKD-ja vëzhgoi ankesa të shumta për shpifje, ku shpesh përfshiheshin zyrtarë publikë duke paditur gazetarë dhe aktivistë. Disa raste ishin Padi Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP) që shënjestronin mediat dhe aktivistët. Ndërsa gjykatat në përgjithësi i trajtojnë rastet në mënyrë të drejtë, shqetësimet vazhdojnë për efikasitetin e sistemit të drejtësisë në zgjidhjen e tyre të menjëhershme. Ligjet për shpifjen mund të penalizojnë në mënyrë të padrejtë gazetarët, ndonjëherë duke favorizuar zyrtarët publikë. Numri i saktë i padive për shpifje kundër gazetarëve nuk është i sigurt. Gazetarët nuk frenohen nga ligjet për shpifjen, por shqetësohen se mund të ndëshkojnë pa dashje raportimin e vërtetë. Pavarësisht përpjekjeve, marrja e të dhënave gjithëpërfshirëse për paditë për shpifje mbetet sfiduese.

TREGUESI 1.2

— KONFIDENCIALITETI I BURIMEVE TË GAZETARËVE ËSHTË I GARANTUAR NË LEGJISLACION DHE RESPEKTOHET NGA AUTORITETET

Rezultati për 2022: 4.61 / Rezultati për 2023: 4.59

Në përgjithësi, situata mbetet e ngjashme me vitin 2023 me përmirësim mikroskopik. Në Kosovë, ligjet mbrojnë burimet e gazetarëve, duke siguruar konfidencialitetin e tyre. Sipas Ligjit Nr. 04/L-137, gazetarët nuk mund të detyrohen të zbulojnë burime nëse nuk urdhërohet nga gjykata për të parandaluar dëmtimin e rëndë. Në vitin 2023, nuk u regjistrua asnjë rast i zbulimit të burimit. Gazetarët ndjehen të lirë të kenë qasje në burime, duke theksuar ligjet e Kosovës që ruajnë konfidencialitetin e burimeve.

TREGUESI 1.3

— LIGJET E TJERA ZBATOHEN NË MËNYRË OBJEKTIVE DHE U MUNDËSOJNË GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE TË PUNOJNË LIRSHËM DHE TË SIGURT

Rezultati për 2022: 3.06 / Rezultati për 2023: 3.02

Në Kosovë, paditë SLAPP vazhdojnë të mos njihen, duke i lënë gazetarët të pambrojtur pa garanci ligjore. Megjithatë,

që nga viti 2023, nuk ka pasur asnjë rast të raportuar të zbatimit diskriminues të ligjeve për të heshtur gazetarët përmes shpenzimeve ligjore. Disa gazetarë janë përballur me padi të shumta për shpifje, por frika nga reagimi i publikut shpesh çon në hezitim për t'i bërë publike rastet e tyre. Për shembull, gazetari M.B. pranoi dy padi për shpifje me radhë dhe u paralajmërua për të tretën. Këto procese gjyqësore, të njohura zakonisht si paditë SLAPP, synojnë t'u mbyllin gojën gazetarëve duke u vendosur barra të mëdha financiare, duke penguar detyrat e tyre profesionale.

TREGUESI 1.4

— GAZETARËT JANË TË LIRË TË USHTROJNË PROFESIONIN E TYRE DHE TË KRIJOJNË, ANËTARËSOHEN DHE MARRIN PJESË NË SHOQATAT E TYRE

Rezultati për 2022: 3.98 / Rezultati për 2023: 3.96

Në Kosovë gazetarët operojnë pa pasur nevojë për licenca shtetërore, duke gëzuar liri të pakufizuar për të punuar. Ndërsa nuk janë të mandatuar, ata inkurajohen të mbajnë kartelë identifikimi të lëshuar nga organizata mediale kur raportojnë për ndonjë ngjarje. Nuk janë bërë përpjekje kohët e fundit për të filluar me licencimin shtetëror. Në përgjithësi, gazetarët nuk përballen me probleme të njohjes ose raportimit të ngjarjeve, me asnjë mohim të raportuar në vitin 2023. Nuk ka pasur presion për gazetarët për t'iu bashkuar shoqatave dhe nuk kishte shenja të organizatave të rreme mediatike që minonin grupet e mirëfillta gazetareske.

TREGUESI 1.5

— POZICIONI I PUNËS I GAZETARËVE ËSHTË I QËNDRUESHËM DHE I MBROJTUR NË VENDIN E PUNËS

Rezultati për 2022: 3.20 / Rezultati për 2023: 3.10

Një e katërta e gazetarëve punojnë me kontrata me afat të caktuar, shumica prej tyre me marrëveshje të përkohshme që zgjasin një vit. Disa kanë marrëveshje të tjera. Gazetarëve të TSHP-së u mungon sigurimi shoqëror, por kushtet e sektorit privat janë përmirësuar. Pagat u rritën me 28%, ku më pak fituan deri në 350 euro dhe më shumë fituan deri në 600 ose 800 euro. Profesionistëve të lirë u mungon kompensimi i pensionit dhe angazhohen me punë shtesë. Pronarët e mediave monitorojnë orët e redaksisë, duke ndikuar në pagat, pa kompensim për orët e punës në terren. Gazetarët e mediave të vogla përballen me sfida pagash. Mediave private u mungojnë sindikatat dhe mbështetja nga pronarët për shoqatat e gazetarëve është e paqartë. Marrëveshja kolektive e Kosovës vlen vetëm për punonjësit e TSHP-së.



Parandalimi i duhur

Gazetarët dhe aktorët e medias kanë akses te masat e menjëhershme dhe efektive mbrojtëse kur ndjehen të kërcënuar

3.51

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias (jeta ose integriteti fizik i të cilëve janë në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë akses te mekanizmat specifikë...

3.44

Gazetare gra kanë akses te masat ligjore dhe mekanizmat e mbështetjes kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore

3.31

Është krijuar praktika e rregullt e dënimit publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave

2.88

Organet e policisë janë të ndjeshme ndaj çështjes së mbrojtjes së gazetarëve

3.65

1.00

Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e menjëhershme të gazetarëve në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve nuk ekzistojnë. Zyrtarët inkurajojnë sulmet ndaj gazetarëve dhe policët i trajtojnë gazetarët jashtëzakonisht ashpër.

2.00

3.00

4.00

5.00

6.00

7.00

Janë krijuar të gjithë mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e menjëhershme të gazetarëve në rast sulmesh. Zyrtarët dekurajojnë qartë dhe sistematikisht sulmet ndaj gazetarëve dhe organet e policisë i trajtojnë me respekt gazetarët.

TREGUESI 2.1

— GAZETARËT DHE AKTORËT E MEDIAVE KANË QASJE NË MASAT MBROJTËSE TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE KUR KËRCËNOHEN

Rezultati për 2022: 3.52 / Rezultati për 2023: 3.51

Mbrojtja për gazetarët dhe aktorët e mediave në Kosovë mbetet e njëjtë si në vitin paraprak dhe është mjaft e shpejtë dhe efektive. Përveç Policisë së Kosovës, një adresë tjetër ku gazetarët tentojnë të raportojnë gjuhën e urrejtjes dhe rastet e rënda me rrezik për jetën është edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, i cili në shumicën e rasteve është pika e tyre kryesore e kontaktit dhe madje adresa kryesore ku i raportojnë rastet e tyre. Për më tepër, bazat e të dhënave të AGK-së dhe PK-së kanë mospërputhje sepse disa raste nuk janë raportuar në të dyja institucionet, respektivisht. Nuk ka raste të njohura të autoriteteve përkatëse që nuk përgjigjen ose refuzojnë të përpunojnë/pranojnë raporte nga gazetarët ose organet e mediave në lidhje me shkeljet e të drejtave të tyre. Për më tepër, me kërkesë të këshilltarit ligjor të AGK-së, Inspektorati Shtetëror i Punës ka trajtuar tri shkelje në vendin e punës të raportuara në mënyrë anonime nga gazetarët.

TREGUESI 2.2

— GAZETARËT DHE AKTORËT E TJERË TË MEDIAS (JETA OSE INTEGRITETI FIZIK I TË CILËVE JANË NË RREZIK REAL DHE TË MENJËHERSHËM) KANË QASJE NË MEKANIZMA TË VEÇANTË MBROJTJEJE/SIGURIE

Rezultati për 2022: 3.48 / Rezultati për 2023: 3.44

Përveç prezencës së zbatimit të ligjit dhe mekanizmave të tjerë të zhvilluar nga shteti që synojnë ruajtjen e sigurisë së gazetarëve, ekziston një dispozitë mbrojtëse brenda sistemit ligjor, veçanërisht në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Kjo kornizë shtrinë mbrojtjen ndaj çdo individi që mund të bjerë viktimë e veprave penale, duke përfshirë gazetarët që përballen me kërcënime serioze për jetën e tyre. Në Kosovë, mungesa e një procedure sistematike të vlerësimit të rrezikut për gazetarët dhe mbrojtjen e qytetarëve tregon një boshllëk potencial në garantimin e sigurisë së tyre. Vendosja e një procedure të tillë është e rëndësishme për identifikimin e kërcënimeve specifike dhe formulimin e strategjive efektive zbutëse. Në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, çdo person që mund të jetë viktimë e veprave penale për shkak të profesionit të tij/saj mbrohet, ky legjislacion vlen edhe për gazetarët, pasi nuk ka dispozita ligjore që mbrojnë gazetarët në veçanti. Po ashtu, përveç Policisë së Kosovës, nuk ka asnjë mekanizëm tjetër të veçantë të zhvilluar nga institucionet shtetërore për të mbështetur sigurinë e gazetarëve.

TREGUESI 2.3

— GAZETARET FEMRA KANË QASJE NË MASAT LIGJORE DHE MEKANIZMAT MBËSHTETËS KUR PËRBALLEN ME KËRCËNIME, NGACMIME DHE DHUNË ME BAZË GJINORE.

Rezultati për 2022: 3.34 / Rezultati për 2023: 3.31

Ekzistojnë mekanizma shtetërorë për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Në kuadër të Prokurorisë së Shtetit funksionon Zyra për Mbrojtjen e Viktimave e cila gjithashtu përfaqëson rastet e dhunës në baza gjinore, ndërsa në kuadër të Agjencisë për ndihmë juridike falas, ndihma juridike falas u ofrohet viktimave të dhunës në bazë gjinore kur viktimat nuk janë në gjendje të paguajnë atë. Ekziston edhe Institucioni i Avokatit të Popullit ku viktimat mund të kërkojnë ndihmë. Përveç kësaj, gazetaret femra kanë qasje në të njëjtat masa ligjore dhe mekanizma mbështetës si edhe bashkëqytetarët e tyre femra. Megjithëse gazetaret gra besojnë se dallimet në bazë gjinore nuk ekzistojnë në mënyrën se si institucionet i trajtojnë rastet e tyre, natyra e kërcënimeve me të cilat përballen sugjeron se ato kanë më shumë gjasa të synohen në një nivel personal dhe jo vetëm profesional, siç shihet në rastet që përfshijnë gazetarët meshkuj. Në AGK janë raportuar 11 sulme ndaj gazetarëve gra, 17 sulme ndaj gazetarëve burra dhe 46 sulme ndaj grupeve dhe ekipeve mediatike.

TREGUESI 2.4

— ËSHTË VENDOSUR PRAKTIKA E DËNIMIT TË RREGULLT PUBLIK TË KËRCËNIMEVE DHE SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE MEDIAVE

Rezultati për 2022: 2.92 / Rezultati për 2023: 2.88

Në vitin 2023 Praktika e dënimit të rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave në Kosovë mbeten jokonsistente. Pavarësisht rritjes së vetëdijesimit për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të gazetarëve, ka sfida të vazhdueshme. Ndërkohë që institucionet qeveritare i njohin sulmet fizike ndaj gazetarëve si shkelje të lirisë së shprehjes dhe të drejtave të njeriut, ato vazhdojnë të bëjnë deklarata vetëm në këto raste, duke neglizhuar rastet e sulmeve verbale. Kjo mungesë e mbështetjes së vazhdueshme publike për gazetarët kontribuon në një trend shqetësues të rritjes së sulmeve verbale, të cilat AGK-ja thekson se rrezikon sigurinë e gazetarëve dhe inkurajon kërcënime dhe ngacmime të mëtejshme, veçanërisht në internet.

TREGUESI 2.5

— AUTORITETET POLICORE JANË TË NDJESHME NDAJ ÇËSHTJEVE TË MBROJTJES SË GAZETARËVE

Rezultati për 2022: 3.67 / Rezultati për 2023: 3.65

Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës mbetet konsistent në adresimin e çështjeve të mbrojtjes së gazetarëve. Ashtu si në vitin 2022, autoritetet policore vazhdojnë të demonstrojnë ndjeshmëri ndaj profesionit të gazetarit. Kjo tregon respekt të vazhdueshëm për të drejtat e gazetarëve dhe një përkushtim për t'u mundësuar atyre që të kryejnë detyrat e tyre pa ndërhyrje, duke reflektuar një trend pozitiv në marrëdhëniet ndërmjet policisë dhe punonjësve të mediave në Kosovë.



Procesi i rregullt

Njësitë dhe/ose oficerët e investigimit të specializuara janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve

3.66

Hetimet për sulme të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë efektive (të pavarur, të plotë dhe të menjëhershme)

3.00

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen me efikasitetet nga format e ndryshme të ngacmimeve online


2.94

Hetimet e të gjitha formave të sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente

3.13

Autoritetet shtetërore krijojnë sisteme cilësore të mbledhjes së statistikave për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë

3.60



TREGUESI 3.1

— NJËSITË E SPECIALIZUARA TË HETIMIT DHE/OSE OFICERËT JANË TË PAJISUR ME EKSPERTIZËN PËRKATËSE PËR HETIMIN E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE

Rezultati për 2022: 3.68 / Rezultati për 2023: 3.66

Situata në vitin 2023 mbetet mjaft e ngjashme me vitin paraprak, pasi institucionet në Kosovë vazhdojnë të përballen me sfidat në adresimin e rasteve që kanë të bëjnë me gazetarët dhe lirinë e mediave. Ndonëse ka pasur përpjekje për përmirësimin e situatës, si krijimi i bazës së të dhënave të padive nga AGK-ja, mungesa e njësive të specializuara hetimore apo oficerëve të pajisur me ekspertizën përkatëse vazhdon. Përkundër emërimit të koordinatorëve në kuadër të policisë, prokurorisë dhe gjykatave për të trajtuar rastet e kërcënimeve, sulmeve dhe ngacmimeve ndaj gazetarëve, ende ekziston një mungesë e dukshme e profesionalizmit dhe ekspertizës së duhur në lidhje me garancitë ligjore të aplikueshme të parashikuara nga legjislacioni në Kosovë. Prandaj, ndërkohë që janë ndërmarrë disa hapa për të adresuar këtë çështje, nevojiten ende përmirësime të rëndësishme për të siguruar mbrojtjen dhe trajtimin e duhur të rasteve që përfshijnë gazetarët.

TREGUESI 3.2

— HETIMET E SULMEVE TË RËNDA FIZIKE NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE KRYHEN ME EFIKASITET (NË MËNYRË TË PAVARUR, TËRËSISHT DHE MENJËHERË)

Rezultati për 2022: 3.02 / Rezultati për 2023: 3.00

Situata për hetimin e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të mediave mbetet e ngjashme me vitet e mëparshme. Me gjithë urgjencën fillestare në reagimet e para të policisë dhe prokurorisë për raste të tilla, efikasiteti i përgjithshëm i hetimeve vazhdon të jetë i ngadaltë dhe joefektiv. Në rastet si ai i Valon Sylës, ku sulmuesit u identifikuan dhe u dënuan me nga dy vjet burg, trendi më i gjerë i hetimeve të ngadalta dhe joefektive vazhdon edhe me rastet e pazgjidhura të viteve të kaluara. Ndërsa mund të ketë njëfarë progresi, si dënimet në raste individuale, çështjet sistematike që ndikojnë në efikasitetin, pavarësinë, tërësinë dhe shpejtësinë e hetimeve mbeten kryesisht të patrajtuara.

TREGUESI 3.3

— GAZETARËT DHE AKTORËT E TJERË TË MEDIAVE MBROHEN NË MËNYRË EFIKASE NGA FORMA TË NDRYSHME TË NGACMIMEVE NË INTERNET.

Rezultati për 2022: 2.98 / Rezultati për 2023: 2.94

Në krahasim me vitin 2022, ku gazetarët iu nënshtruan 9 sulmeve online, në vitin 2023, gazetarët kosovarë u përballën me 8 raste të ngacmimeve në internet, krahas përpjekjeve të qeverisë për të kontrolluar përmbajtjen mediale, veçanërisht duke synuar Klan Kosovën. Asociacioni

i Gazetarëve të Kosovës kritikoi ashpër këto veprime, duke vënë në pah kërcënimet ndaj lirisë së mediave. Kjo nënvizon nevojën e vazhdueshme për masa të forta për të mbrojtur gazetarët dhe aktorët e mediave nga një ndërhyrje e tillë.

TREGUESI 3.4

— HETIMET PËR TË GJITHA LLOJET E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE KRYHEN NË MËNYRË TRANSPARENTE

Rezultati për 2022: 3.18 Rezultati për 2023: 3.13

Në vitin 2023, transparenca në hetimet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të mediave vazhdon të jetë një çështje urgjente. Këshilli Gjyqësor i Kosovës mund të ketë ndërmarrë hapa drejt vendosjes së modaliteteve për mbledhjen e të dhënave që ndikojnë në indeksin e sigurisë së gazetarëve, por transparenca e përgjithshme në procedurat gjyqësore mbetet nën nivelet e kënaqshme. Kështu, ndonëse mund të jenë bërë përpjekje, ka ende shumë hapësirë për përmirësime për të siguruar që hetimet dhe procedurat gjyqësore të zhvillohen në mënyrë transparente në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave në Kosovë.

TREGUESI 3.5


— SISTEMET E GRUMBULLIMIT TË STATISTIKAVE CILËSORE TË KRIJUARA NGA AUTORITETET SHTETËRORE PËR TË FRENUAR MOSNDËSHKIMIN

Rezultati për 2022: 3.65 / Rezultati për 2023: 3.60

Krahas situatës së pandryshuar në lidhje me publikimin e raporteve statistikore vjetore nga policia, prokuroria dhe gjykatat në vitin 2023, AGK-ja ka ndërmarrë hapa proaktivë për adresimin e kësaj çështje. AGK-ja tani është duke krijuar dhe përditësuar bazën e saj të të dhënave për të dokumentuar rastet e gazetarëve.

IV

Siguria aktuale



TREGUESI 4.1

— KËRCËNIMET DHE NGACMIMET QË NUK LIDHEN ME SIGURINË FIZIKE

Kjo mund të përfshijë mbikëqyrjen ose përcjelljen; ngacmimi me telefon; ngacmim arbitrar gjyqësor ose administrativ; deklarata agresive nga zyrtarët publikë; lloje të tjera presionesh që kërcënojnë sigurinë e gazetarëve gjatë kryerjes së punës së tyre. Këto lloj kërcënimesh nuk përfshijnë ngacmimin dhe bullizmin në mjedisin e punës.

Rezultati për 2022: 2.17 / Rezultati për 2023: 2.03

Në vitin 2023, numri i kërcënimeve dhe ngacmimeve jofizike u rrit me një në krahasim me vitet e mëparshme. Në bazën e të dhënave të AGK-së janë regjistruar gjithsej 20 raste. Megjithatë, pavarësisht se nuk përfaqësojnë një ndryshim të rëndësishëm në numër, ashpërsia dhe shpeshtësia e këtyre kërcënimeve janë rritur. Numri i raportuar nuk pasqyron me saktësi shtrirjen e vërtetë të kërcënimeve dhe ngacmimeve jo-fizike, pasi gazetarët mund të mos raportojnë të gjitha rastet, veçanërisht ato që përfshijnë ngacmimin në internet. Ka pasur edhe raste kur zyrtarë të partisë në pushtet kanë përdorur gjuhë të rrezikshme dhe të papranueshme ndaj mediave dhe gazetarëve.

TREGUESI 4.2

— KËRCËNIME NDAJ JETËS DHE SIGURISË FIZIKE TË GAZETARËVE

Kjo mund të përfshijë thirrjen për vrasjen e gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të tyre; duke bërë thirrje për sulme fizike ndaj gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të tyre. Kërcënimet mund të jenë të drejtpërdrejta ose të dërgohen nëpërmjet palëve të treta; dërguar në mënyrë elektronike ose në komunikim të drejtpërdrejtë; ato mund të jenë të nënkuptuara dhe të qarta.

Rezultati për 2022: 2.54 / Rezultati për 2023: 2.17

Në krahasim me vitin 2022, ku nuk ka pasur raste të kërcënimeve ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve, gjatë vitit 2023 janë raportuar 11 raste të kërcënimeve ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve në AGK gjatë vitit 2023. Shumica e këtyre kërcënimeve vinin nga qytetarët përmes platformave të ndryshme të mediave sociale, duke përfshirë Facebook, Instagram dhe TikTok. Rasti më i rëndë ishte një tentativë për zjarrvënie në garazhin/shtëpinë e Alban Selimit.

TREGUESI 4.3

— SULMET AKTUALE

Kjo mund të përfshijë dëmtim aktual fizik ose mendor, rrëmbim, pushtim të shtëpisë/zyrës, sekuestrim të pajisjeve, ndalim arbitrar, tentativa të dështuara për vrasje, etj.

Rezultati për 2022: 2.98 / Rezultati për 2023: 2.64

Gjatë vitit 2023, në Kosovë kanë ndodhur 20 raste të sulmeve, ku disa kanë përfshirë më shumë se një ekip mediatik në të njëjtën kohë. Shumica e këtyre sulmeve ndodhën në pjesën veriore të Kosovës. Krahasuar me vitin 2022, numri i rasteve u rrit, ku shumica e këtyre sulmeve u përqendruan në 29 dhe 30 maj, si dhe në 16 qershor. Njëmbëdhjetë nga 20 raste kanë ndodhur në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe komunën e Mitrovicës së Veriut. Një nga rastet më të rënda ishte operatori i kamerës Bardh Bektashi, i ndjekur nga Pleurat Salihu, i cili pësoi një thyerje të krahut.

TREGUESI 4.4

— KËRCËNIME DHE SULME NDAJ MEDIAVE DHE SHOQATAVE TË GAZETARËVE

Kërcënimet mund të përfshijnë telefonata ngacmuese, ngacmime arbitrare gjyqësore ose administrative, deklarata agresive nga zyrtarët publikë dhe forma të tjera presioni (mbishkrime, postime kërcënuese, etj.). Sulmet aktuale përfshijnë pushtimin e zyrave, sekuestrimin e pajisjeve, thyerjen e pajisjeve, automjeteve, etj.

Rezultati për 2022: 2.97 / Rezultati për 2023: 2.52

Në krahasim me vitin 2021, ku kishte 3 raste, numri u dyfishua në vitin 2022, duke arritur në 6 raste. Megjithatë, gjatë vitit 2023, numri i kërcënimeve dhe sulmeve pësoi një rritje të paprecedentë. Janë raportuar 23 raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj mediave, ku 16 kanë ndodhur në veri të Kosovës, veçanërisht gjatë majit dhe qershorit. Kjo paraqet një përshkallëzim të konsiderueshëm, me një rritje prej 14 rastesh krahasuar me vitin 2022. Gjithashtu, ashpërsia e rasteve është përshkallëzuar, ku këto incidente kanë ndodhur kryesisht gjatë raportimeve të gazetarëve nga tensionet në veri. Gazetarët u përballën me kërcënime të ndryshme duke përfshirë dëmtimin e pronës personale, dëmtimin e pronës intelektuale dhe forma të tjera agresioni. Për shembull, një automjet i TëVë1 fillimisht është dëmtuar dhe më pas i është vënë flaka. Akte të ngjashme vandalizmi janë parë edhe në mjete të tjera mediatike, ku janë dëmtuar edhe shumë kamera dhe telefona.

Titulli origjinal
Kosovë – Treguesit e nivelit të lirisë së mediave
dhe Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve 2023

Botuesi
Asociacioni i Gazetarëve Kosovës
Prishtinë, 2023



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

Autorë
Getoarbë Mulliqi dhe Leonita Morina

Ekspert për media
Abit Hoxha

Ekspert Ligjor
Yll Zekaj

Përkthyer nga
Anyla Zajmij

Foto e kopertinës
Andrija Vukelić

Dizajni
comma.rs



Ky publikim është krijuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Asociacionit të Gazetarëve të Maqedonisë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.